	5. Për të shmangur kontrolle të panevojshme Autoriteti kompetent mund të konsiderojë të pakaluar kontrollin për mjetet, të cilat kanë vlera të matura të cilat tejkalojnë konsiderueshëm vlerat e lejuara pas më pak se tri cikle përshpejtimi të lirë ose pas cikleve të pastrimit. Gjithashtu, për të shmangur kontrolle të panevojshme, autoriteti kompetent mund të konsiderojë kontrollin të kaluar për mjete të cilat kanë vlera të matura që janë ndjeshëm nën kufijtë e lejuar pas më pak se tri cikle përshpejtimi të lira ose pas cikleve të pastrimit. Në mënyrë alternative, matje duke përdorur një pajisje të komanduar dhe të konfirmuar nga metoda standarde kontrolli.				
8.4 Elemente të tjera të lidhur me mjedisin					

8.4.1 Rrjedhje lëngjesh		Rrjedhje e tepruar lëngjesh, përveç ujit, të cilët mund të dëmtojnë mjedisin ose të përbëjë rrezik ndaj përdoruesve të tjerë të rrugës Formim i vazhdueshëm pikash të cilat paraqesin një rrezik shumë serioz		X	X
9. TESTIME SUPLEMENTARE PËR MJETET E KATEGORIVE M_2, M_3 QË TRANSPORTOJNË UDHËTARË					
9.1 Dyert					
9.1.1 Dyert hyrëse dhe dalëse	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit.	a) Funksionim me defekt		X	
		b) Gjendje e përkeqësuar Mund të shkaktojë lëndime	X	X	
		c) Sistemet e kontrollit për daljet e emergjencës me defekt		X	
		d) Komandimi në distancë i dyerve ose pajisjet paralajmëruese me defekt		X	
9.1.2 Daljet e emergjencës	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit (aty ku është e mundur)	a) Funksionim me defekt		X	
		b) Shenjat e daljeve të emergjencës të palexueshme. Shenjat e daljeve të emergjencës mungojnë.	X	X	
		c) Mungon çekiçi për thyerjen e xhamave.	X		
		d) Dalja e bllokuar.		X	
9.2 Sistemi kundër avullimit dhe sistemi kundër ngrirjes(X)[2]	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit	a) Nuk funksionon në mënyrë korrekte Ndikon në funksionimin e sigurt të mjetit	X	X	
		b) Emetim i gazrave toksikë ose gazrave të shkarkimit në kompartimentin e shoferit ose të udhëtarëve Rrezikim i shëndetit të personave brenda në mjet		X	X
		c) Antingrirja me defekt (nëse është e detyrueshme)		X	
9.3 Sistemi i ventilimit dhe sistemi i ngrohjes (X)[2]	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit	a) Funksionim me defekt. Rrezikim i shëndetit të personave brenda në mjet.	X	X	
		b) Emetim i gazrave toksikë ose gazrave të shkarkimit në kompartimentin e shoferit ose të udhëtarëve Rrezikim i shëndetit të personave brenda në mjet		X	X
9.4 Ndenjëset					

9.4.1 Ndenjëset e udhëtarëve (përfshirë ndenjëset për personelin shoqërues dhe sistemet mbajtës të fëmijëve, kur aplikohet)	Inspektim vizual	Ndenjëset e palosshme (nëse janë të lejuara) nuk punojnë automatikisht Bllokojnë një dalje emergjence	X	X	
9.4.2 Ndenjësja e shoferit (kërkesat shtesë)	Inspektim vizual	a) Pajisjet speciale, si, p.sh., shtresa mbrojtëse kundër reflektimit me defekt Fusha e shikimit e reduktuar	X	X	
		b) Mbrojtja e shoferit e pasigurt Mund të shkaktojë lëndime	X	X	
9.5 Dritat e brendshme dhe udhëzimet për udhëtarët (X)[2]	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit.	Pajisja me defekt Nuk funksionojnë fare	X	X	
9.6 Korridoret, hapësira për qëndrim në këmbë të udhëtarëve	Inspektim vizual	a) Dyshemeja e pasigurt Stabiliteti i reduktuar		X	X
		b) Mbajtëset ose dorezat për mbajtje me defekt Të pasigurta ose të papërdorshme	X	X	
9.7 Shkallët dhe platformat	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit (ku është e mundur)	a) Gjendje e përkeqësuar Të dëmtuara Stabiliteti i reduktuar	X	X	X
		b) Platformat hyrëse nuk funksionojnë në mënyrë korrekte		X	
9.8 Sistemi i komunikimit me udhëtarët (X)[2]	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit	Sistemi me defekt Nuk funksionon fare	X	X	
9.9 Mbishkrimet (X)2	Inspektim vizual	a) Mungojnë, janë me gabime ose të palexueshme Informacion i gabuar	X	X	
9.10 Kërkesa lidhur me transportimin e fëmijëve(X)[2]					
9.10.1 Dyert	Inspektim vizual.	Mbrojtja e dyerve nuk është në përputhje me kërkesat[1], sa i përket kësaj forme transporti		X	
9.10.2 Pajisjet sinjalizuese dhe të posaçme	Inspektim vizual.	Pajisjet sinjalizuese ose të posaçme mungojnë	X		
9.11 Kërkesa lidhur me transportimin e personave me lëvizshmëri të kufizuar (X)[2]					

9.11.1 Dyert, rampat dhe ashensorët	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit	a) Funksionim me defekt Funksionimi i sigurt i reduktuar	X	X	
		b) Gjendje e përkeqësuar Stabiliteti i reduktuar; mund të shkaktojnë lëndime	X	X	
		c) Komanda/t me defekt Funksionimi i sigurt i reduktuar	X	X	
		d) Pajisja/et paralajmëruese me defekt Nuk funksionojnë fare	X	X	
9.11.2 Sistemi për fiksimin e karrocave me rrota	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit (nëse është e mundur)	a) Funksionim me defekt Funksionimi i sigurt i reduktuar	X	X	
		b) Gjendje e përkeqësuar. Stabiliteti i reduktuar; mund të shkaktojë lëndime.	X	X	
		c) Komanda/t me defekt Funksionimi i sigurt i reduktuar	X	X	
9.11.3 Pajisjet sinjalizuese dhe të posaçme	Inspektim vizual	Pajisjet sinjalizuese ose të posaçme mungojnë		X	

[1.] Efikasiteti i përqindjes së frenimit llogaritet duke ndarë forcën totale të frenimit të arritur, kur freni i nënshtrohet peshës së mjetit ose, në rastin e një gjysmërimorkioje, shuma e ngarkesave të boshtit dhe më pas duke shumëzuar rezultatin me 100.

[2.] Kategoritë e mjeteve që janë jashtë fushëveprimit të këtij udhëzimi janë përfshirë si udhëzuese.

[3.] 48% për mjetet që nuk janë të pajisur me sistem ABS ose miratim tipi para 1 tetorit 1991.

[4.] 45% për mjetet e regjistruara pas vitit 1988 ose nga data e përcaktuar në kërkesat, cilado të jetë më e vonshme.

[5.] 43% për gjysmërimorkiot dhe rimorkiot të regjistruara pas vitit 1988 ose nga data në kërkesa, cilado të jetë më e vonshme.

[6.] 2,2 m/s2 për mjetet N1, N2 dhe N3.

[7.] Miratimi tipit, në përputhje me direktivën 70/220/KEE, rregulloren (KE) nr. 715/2007, aneksin I, tabelën 1 (Euro 5), direktivën 88/77/KEE dhe direktivën 2005/55/KE.

[8.] Miratimi tipit, në përputhje me Rregulloren (KE) nr. 715/2007, Aneksin I, Tabelën 2 (Euro 6) dhe Rregulloren (KE) Nr. 595/2009 (Euro VI).

[9.] Miratimi tipit, sipas Rregullores (KE) nr. 715/2007 shtojca I, tabela 2 (Euro 6) dhe rregullorja (KE) nr. 595/2009 (Euro VI).

[10.] Miratimi tipit, në përputhje me kufizimet në rreshtin B, seksioni 5.3.1.4 i aneksit I të direktivës 70/220/KEE; rreshti B1, B2 ose C, seksioni 6.2.1 i aneksit I të direktivës 88/77/KEE ose i regjistruar për së pari ose i futur në shërbim pas 1 korrikut 2008.

SHËNIME:

1. "Kërkesat" përcaktohen nga miratimi i tipit në datën e miratimit, regjistrimit të parë ose të hyrjes së parë në shërbim, si dhe me detyrimet lidhur me modifikimet ose nga legjislacioni kombëtar në vendin e regjistrimit. Këto arsye për dështim zbatohen vetëm kur përputhshmëria me kërkesat është kontrolluar.

2. (X) identifikon elementet që kanë të bëjnë me gjendjen e mjetit dhe përshtatshmërinë e tij për përdorim në rrugë, por që nuk konsiderohen thelbësore në një kontroll teknik të mjetit.

3. Modifikimi i pasigurt nënkupton një modifikim që ndikon negativisht në sigurinë rrugore të automjetit ose ka një efekt në mënyrë disproporcionale të pafavorshme në mjedis.

E. Për kontrollin e këtij elementi kërkohet pajisje.

ANEKSI III

I. Parimet e sigurimit të ngarkesave

1. Sigurimi i ngarkesës duhet të përballojë forcat e mëposhtme që rezultojnë nga përshpejtimet/ngadalësimet e automjetit:

- në drejtimin e lëvizjes: 0,8 herë peshën e ngarkesës; dhe
- në drejtim anësor: 0,5 herë peshën e ngarkesës; dhe
- kundër drejtimit të lëvizjes: 0,5 herë peshën e ngarkesës;
- dhe në përgjithësi duhet të parandalojë animin dhe zhbalancimin e ngarkesës.

2. Shpërndarja e ngarkesës duhet të marrë parasysh ngarkesat maksimale të autorizuara të boshtit, si dhe ngarkesat minimale të nevojshme të boshtit brenda kufijve të masës së autorizuar maksimale të mjetit, në përputhje me dispozitat ligjore mbi peshat dhe dimensionet e mjeteve.

3. Gjatë sigurimit të ngarkesës, duhet të merren parasysh kërkesat e zbatueshme lidhur me fuqinë e komponentëve të caktuar të mjetit, si: koka e mjetit, pjesët anësore, skajet, stekat ose pikat e fiksimit, kur këta përbërës përdoren për sigurimin e ngarkesës.

4. Për sigurimin e ngarkesës, mund të përdoren një ose më shumë ose një kombinim i metodave të mëposhtme të lidhjes:

- mbyllje;
- bllokimi (lokal/i përgjithshëm);
- lidhje e drejtpërdrejtë;
- lidhje e përgjithshme.

5. STANDARDET E APLIKUESHME

Standardi	Subjekti
- EN 12195-1	Llogaritja e forcave të lidhjes
- EN 12640	Pikat e fiksimit
- EN 12642	Forca e strukturës së trupit të mjetit
- EN 12195-2	Rrjetë lidhëse të prodhuara nga fibrat
- EN 12195-3	Zinxhirët lidhës
- EN 12195-4	Lidhëset prej çeliku
- ISO 1161, ISO 1496	Kontejnerët ISO
- EN 283	Kontejnerët e këmbyeshëm
- EN 12641	Mbulesat kundër shiut
- EUMOS 40511	Shtyllat - stekat
- EUMOS 40509	Paketim për transport

II. Kontrolli i sigurimit të ngarkesës

1. Klasifikimi i defekteve

Defekte të do të klasifikohen në njërën nga grupet e mëposhtme:

- Defekt i vogël: një defekt i vogël ekziston kur ngarkesa është siguruar siç duhet, por një kështillë sigurie mund të jetë e përshtatshme.
- Defekt i madh: ekziston një defekt i madh kur ngarkesa nuk është siguruar mjaftueshëm dhe është e mundur një zhvendosje ose përmbysje e konsiderueshme e ngarkesës ose e pjesëve të saj.
- Defekt i rrezikshëm: ekziston një defekt i rrezikshëm, kur siguria e trafikut rrezikohet drejtpërdrejt, për shkak të rrezikut të humbjes së ngarkesës ose të pjesëve të saj ose një rreziku që rrjedh direkt nga ngarkesa ose rrezikimi i menjëhershëm për njerëzit.

Kur janë të pranishme disa defekte, transporti klasifikohet në grupin më të lartë të defekteve. Nëse, në rast se ka disa defekte, kur efektet në bazë të kombinimit të këtyre defekteve pritet të përforcojnë njëra-tjetrën, transporti duhet të klasifikohet në nivelin tjetër më të lartë të defekteve.

2. Metoda e kontrollit

Metoda e kontrollit është një vlerësim vizual i përdorimit të duhur të masave të përshtatshme në masën e nevojshme për të siguruar ngarkesën dhe/ose matjen e forcave të tensionit, llogaritjen e efikasitetit të sigurimit dhe kontrollin e certifikatave kur është e përshtatshme.

3. Vlerësimi i defekteve

Tabela 1 përcakton rregullat që mund të zbatohen gjatë një kontrolli të sigurimit të ngarkesës për të përcaktuar nëse gjendja e transportit është e pranueshme.

Kategorizimi i defekteve përcaktohet në bazë të klasifikimeve të përcaktuara në seksionin 1 të këtij kapitulli, rast pas rasti.

Vlerat e deklaruara në tabelën 1 janë të një natyre indikative dhe duhet të shihen si një udhëzues për përcaktimin e kategorisë së një defekti të dhënë në dritën e rrethanave specifike – në varësi të natyrës së ngarkesës dhe në diskrecionin e inspektorit.

Në rastin e një transporti që përfshihet në fushën e transportit të mallrave të rrezikshme mund të zbatohen kërkesa më specifike.

Tabela 1

Elementi	Defektet	Vlerësimi i defekteve		
		I vogël	I madh	I rrezikshëm
A	Ambalazhimi për transport nuk lejon sigurimin e duhur të ngarkesës	Në diskrecionin e inspektorit		
B	Një ose më shumë prej njësive të ngarkesës nuk janë të pozicionuara siç duhet	Në diskrecionin e inspektorit		
C	Mjeti nuk është i përshtatshëm për ngarkesën aktuale (defekte të tjera përveç atyre të listuara në artikullin 10)	Në diskrecionin e inspektorit		
D	Defekte të dukshme të superstrukturës së mjetit (mangësi të tjera përveç atyre të listuara në artikullin 10)	Në diskrecionin e inspektorit		
10	Përshtatshmëria e mjetit			
Elementi	**Defektet**	**Vlerësimi i defekteve**		
		I vogël	**I madh**	**I rrezikshëm**
10.1	Pjesa e përparme (nëse përdoret për sigurimin e ngarkesës)			
10.1.1	Pjesërisht të dobësuar nga ndryshku dhe deformimet Pjesa e thyer duke rrezikuar integritetin e kompartimentit të ngarkesës		x	x
10.1.2	Forcë e pamjaftueshme (certifikata ose etiketa nëse është e mundur) Lartësi e pamjaftueshme në raport me ngarkesën e transportit		x	x
10.2	Pjesët anësore (nëse përdoren për sigurimin e ngarkesës)			
10.2.1	Pjesërisht të dobësuara nga ndryshku, deformimet, gjendje jo e mirë e menteshave dhe e bravave Pjesë të thyera; menteshat ose bravat mungojnë ose janë jofunksionale		x	x
10.2.2	Forcë e pamjaftueshme në krahët (certifikata ose etiketa nëse është e mundur) Lartësi e pamjaftueshme në raport me ngarkesën e transportit		x	x
10.2.3	Dërrasat e pjesës anësore në gjendje jo të mirë Pjesë e thyer		x	x
10.3	Pjesa e mbrapme (nëse përdoret për sigurimin e ngarkesës)			
10.3.1	Pjesët të dobësuara nga ndryshku, deformimet, gjendje jo e mirë e menteshave dhe e bravave Pjesët të thyera; menteshat ose bravat mungojnë ose janë jofunksionale		x	x
10.3.2	Forcë e pamjaftueshme (certifikata ose etiketa nëse është e mundur) Lartësi e pamjaftueshme në raport me ngarkesën e transportit		x	x
10.4	Stekat dhe shufrat (nëse përdoren për sigurimin e mjetit)			
10.4.1	Pjesët të dobësuara nga ndryshku, deformimet ose fiksimi i pamjaftueshëm në mjet Pjesët të thyera; fiksimi në mjet i paqëndrueshëm		x	x
10.4.2	Forcë ose projektim i pamjaftueshëm Lartësi e pamjaftueshme në raport me ngarkesën e transportit		x	x
10.5	Pikat e fiksimit (nëse përdoren për sigurimin e ngarkesës)			
10.5.1	Gjendje ose projektim i pamjaftueshëm Nuk janë në gjendje të mbajnë peshën e nevojshme		x	x

10.5.2	Numri i pamjaftueshëm Numri i pamjaftueshëm për të mbajtur peshën e nevojshme		x	x
10.6	Struktura të posaçme të kërkuara (nëse përdoren për sigurimin e ngarkesës)			
10.6.1	Gjendje jo e mirë, të dëmtuara Pjesët të thyera; nuk janë në gjendje të mbajnë forcën e nevojshme		x	x
10.6.2	Nuk janë të përshtatshme për transportim ngarkese Mungojnë		x	x
10.7	Dyshemeja (nëse përdoret për sigurimin e ngarkesës)			
10.7.1	Gjendje jo e mirë, e dëmtuar Pjesët të thyera; nuk është në gjendje të mbajë ngarkesën		x	x
10.7.2	Kapacitet jo i mjaftueshëm për të mbajtur ngarkesën Jo në gjendje për të mbajtur ngarkesën		x	x
20.	Metodat e sigurimit të ngarkesës			
20.1	Mbyllja, bllokimi dhe lidhja			
20.1.1	Fiksimi direkt i ngarkesës (bllokimi)			
20.1.1.1	Distancë shumë e madhe me pjesën e përparme, nëse përdoret për sigurimin direkt të ngarkesës Më tepër se 15 cm dhe rrezik për të penetruar murin		x	x
20.1.1.2	Distanca anësore me pjesën anësore shumë e madhe, nëse përdoret për sigurimin direkt të ngarkesës Më tepër se 15 cm dhe rrezik për të penetruar murin		x	x
20.1.1.3	Distanca e mbrapme me pjesën e mbrapme shumë e madhe, nëse përdoret për sigurimin direkt të ngarkesës Më tepër se 15 cm dhe rrezik për të penetruar murin		x	x
20.1.2	Pajisjet siguruese, siç janë: shinat lidhëse, trarët për bllokimin, fiksuesit dhe pykat, përpara, anash, mbrapa			
20.1.2.1	Fiksime jo të përshtatshme në mjet Fiksimet jo të mjaftueshme Nuk janë në gjendje të mbajnë forcën e nevojshme, të lirshme	x	x	x
20.1.2.2	Sigurimi jo i përshtatshëm Sigurimi i pamjaftueshëm Tërësisht joefektiv	x	x	x
20.1.2.3	Përshtatshmëri e pamjaftueshme e pajisjes siguruese Pajisja siguruese tërësisht e papërshtatshme		x	x
20.1.2.4	Përshtatshmëria e metodës së zgjedhur për sigurimin e paketimit jooptimalja Metoda e zgjedhur tërësisht e papërshtatshme		x	x
20.1.3	Sigurimi direkt me rrjeta dhe mbulesa			
20.1.3.1	Gjendja e rrjetave dhe mbulesave (etiketa mungon ose është e dëmtuar por pajisja është akoma në gjendje të mirë) Pajisjet mbajtëse të ngarkesës të dëmtuara. Pajisjet mbajtëse të ngarkesës të përkeqësuara seriozisht dhe nuk janë më të përshtatshme për përdorim	x	x	x
20.1.3.2	Forcë e pamjaftueshme e rrjetave dhe mbulesave. Kapaciteti më pak se 2/3 e forcës mbajtëse të nevojshme.		x	x
20.1.3.3	Lidhje e pamjaftueshme e rrjetave dhe mbulesave. Lidhjet me kapacitet më të vogël mbajtës se 2/3 e forcës mbajtëse të nevojshme.		x	x

20.1.3.4	Përshtatshmëri e pamjaftueshme e rrjetave dhe mbulesave për sigurimin e ngarkesës. Tërësisht e papërshtatshme.		x	x
20.1.4	Ndarja dhe mbushja e njësive të ngarkesës ose hapësirave të lira.			
20.1.4.1	Papërshtatshmëri e ndarjes dhe mbushjes së njësive. Ndarje e tepërt ose mbushje e tepërt e hapësirave të lira.		x	x
20.1.5	Lidhjet direkte (lidhjet horizontale, transversale, diagonale, tërësore dhe kundër rrëshqitjes)			
20.1.5.1	Forca siguruese e nevojshme nuk arrihet Më pak se 2/3 e forcës së nevojshme		x	x
20.2	Sigurimi ndaj fërkimit			
20.2.1	Arritja e forcës siguruese të nevojshme			
20.2.1.1	Forca siguruese e nevojshme nuk arrihet Më pak se 2/3 e forcës së nevojshme		x	x
20.3	Pajisjet mbajtëse të ngarkesës të përdorura			
20.3.1	Papërshtatshmëri e pajisjeve mbajtëse të ngarkesës Pajisje tërësisht e papërshtatshme		x	x
20.3.2	Etiketa mungon ose është e dëmtuar por pajisja është akoma në gjendje të mirë Etiketa mungon ose është e dëmtuar por pajisja tregon shenja përkeqësimi të konsiderueshëm	x	x	
20.3.3	Pajisjet për mbajtjen e ngarkesës të dëmtuara Pajisjet për mbajtjen e ngarkesës seriozisht të përkeqësuara dhe jo më të përshtatshme për përdorim		x	x
20.3.4	Arganot lidhëse të përdorura në mënyrë jokorrekte Arganot lidhëse me defekt		x	x
20.3.5	Përdorimi i mbajtësve të ngarkesës i gabuar (p.sh., mungesë e mbrojtjes së anëve) Përdorimi i pajisjeve mbajtësve të ngarkesës defektoz (p.sh., nyjat)		x	x
20.3.6	Fiksimi i pajisjes mbajtëse të ngarkesës i papërshtatshëm. Më pak se 2/3 e forcës së nevojshme		x	x
20.4	Pajisje shtesë (p.sh., materiali kundër rrëshqitjes, mbrojtësit e anëve, rrëshqitësit)			
20.4.1	Pajisja e përdorur jo e përshtatshme Pajisja e përdorur e gabuar ose me defekt Pajisja e përdorur tërësisht e papërshtatshme	x	x	x
20.5	Transporti i materialeve me masë të madhe, të lehtë dhe të lirshme			
20.5.1	Materialet me masë të madhe çlirohen gjatë lëvizjes së mjetit në rrugë, mund të shkaktojë probleme në trafik Paraqet rrezik për trafikun		x	x
20.5.2	Materialet me masë të madhe nuk janë siguruar në mënyrën e duhur Humbja e ngarkesës paraqet rrezik për trafikun		x	x
20.5.3	Mungesë e mbulesës për mallrat e lehta Humbja e ngarkesës paraqet rrezik për trafikun		x	x
20.6	Transporti i trupave drusore			
20.6.1	Materiali i transportuar pjesërisht i lirshëm			x
20.6.2	Forca siguruese e njësisë së ngarkesës e pamjaftueshme Më pak se 2/3 e forcës së nevojshme		x	x
30.	Ngarkesa tërësisht e pasiguruar			x

ANEKSI IV
(ana e përparme)

SPECIMEN I RAPORTIT TË INSPEKTIMIT TË DETAJUAR TEKNIK NË ANË TË RRUGËS SË BASHKU ME LISTË KONTROLLIN

1. Vendi i inspektimit teknik në anë të rrugës.....
2. Data.....
3. Koha.....
4. Vendi i regjistrimit dhe targa.....
5. Numri i identifikimit/VIN i mjetit.....
6. Kategoria e mjetit:

a) N_2[(a)] (3,5 deri 12 t) ☐
b) N_3[(a)] (më shumë se 12 t) ☐
c) O_3[(a)] (3,5 deri 10 t) ☐
d) O_4[(a)] (më shumë se 10 t) ☐
e) M_2[(a)] (>9 ndenjëse [(b)] deri 5 t) ☐
f) M_3[(a)] (>9 vende [(b)] më shumë se 5 t) ☐
g) T_5 ☐
h) Kategori të tjera: (specifiko)

7. Leximi i odometrit në momentin e inspektimit.
8. Ndërmarrja që kryen transportin

a) Emri dhe adresa ……..
……
b) Numri i licencës komunitare[(c)]

9. Emri i drejtuesit

10. Lista për t'u kontrolluar	kontrolluar[(d)]	nuk kalon kontrollin[(e)]
(0) Identifikimi[(f)]	☐	☐
1) Pajisjet e frenimit[(f)]	☐	☐
2) Drejtimi[(f)]	☐	☐
3. Dukshmëria[(f)]	☐	☐
4. Pajisjet e dritave dhe sistemi elektrik[(f)]	☐	☐
5. Boshtet, rrotat, goma, amortizatorët[(f)]	☐	☐
6. Shasia dhe pajisjet e shasisë[(f)]	☐	☐
7. Pajisje të tjera, përfshirë tahografin dhe pajisjen për reduktimin e shpejtësisë[(f)]	☐	☐
8. Zhurmat, përfshirë gazet dhe rrjedhjen e karburantit dhe/ose vajit[(f)]	☐	☐
9. Teste shtesë për kategorinë e mjeteve M_2 dhe M_3[(f)]	☐	☐
10. Sigurimi ngarkesës[(f)]	☐	☐

11. Përfundimet e inspektimit:

Kalon ☐
Nuk kalon ☐
Ndalim ose kufizim i përdorimit të mjetit, i cili ka defekte serioze ☐

12. Të tjera/shënime.....
13. Autoriteti/oficeri ose inspektori që kreu inspektimin

Nënshkrimi i:

Autoriteti kompetent/oficeri ose inspektori ..... Drejtuesi i mjetit .....

Shënime:
a) Kategoria e mjetit në përputhje me nenin 2 të udhëzimit;
b) Numri i ndenjësve, duke përfshirë ndenjësen e drejtuesit;
c) Nëse është e aplikueshme;
d) "e kontrolluar" nënkupton që të paktën një ose më shumë elemente të inspektimit të këtij grupi, siç listohet në anekset II ose III të udhëzimit, janë kontrolluar dhe nuk janë gjetur defekte ose defekte të lehta.
e) Elementet që nuk e kanë kaluar testin me defekte të mëdha ose serioze të treguar në anën e pasme.
f) Metodat për testimin dhe për vlerësimin e defekteve në përputhje me anekset II ose III.

	Ana e pasme						
0	IDENTIFIKIMI I MJETIT	1.1.12	Tubat elastikë të frenave	1.3	Performanca dhe efektiviteti i frenit ndihmës (të emergjencës)	2.1.4	Funksionimi i lidhjeve në sistemin e drejtimit
0.1	Regjistrimi i targës	1.1.13	Tamburet dhe ferrotat	1.3.1	Performanca	2.1.5	Sistemi drejtimit
0.2	Identifikimi i mjetit/numri i shasisë/numri serial	1.1.14	Tamburet e frenave, disqet e frenave	1.3.2.	Eficienca	2.2	Timoni/ boshti i timonit/doreza
1	SISTEMI FRENIMIT	1.1.15	Kabllot e frenave, shufrat, levat, lidhjet	1.4	Performanca dhe efektiviteti i frenit të dorës	2.2.1	Gjendja e timonit
1.1	Gjendja mekanike dhe funksionimi	1.1.16	Cilindri i frenave	1.4.1	Performanca	2.2.2	Boshti i timonit/ amortizatori
1.1.1	Pedali i frenit	1.1.17	Rregullatori i forcës së frenimit	1.4.2	Eficienca	2.3	Xhokoja e timonit
1.1.2.	Gjendja e pedalit dhe hapi për aktivizimin e frenave	1.1.18	Kompensimi automatik dhe indikatori i konsumit të frenave	1.5	Performanca e sistemit të frenimit me ngadalësim afatgjatë	2.4	Orientimi i rrotave
1.1.3	Pompa e vakumit ose kompresori dhe rezervuarët	1.1.19	Sistemi i frenimit me ngadalësim afatgjatë (nëse automjeti është i pajisur ose nëse e detyrueshme)	1.6	Sistemi i frenimit antibllokazh	2.5	Kurora kthyese e boshtit drejtues të rimorkios
1.1.4	Indikatori i presionit të ulët	1.1.20	Funksionimi automatik i frenave të rimorkios	1.7	Sistemi i frenimit elektronik	2.6	Sistemi i drejtimit elektronik
1.1.5	Valvula e frenit të dorës	1.1.21	Sistemi i frenimit në tërësi	1.8	Lëngu i frenave	3	Shikueshmëria
1.1.6	Aktivizuesi i frenit parkimit, kontrolli i levës, mekanizmi bllokues i frenit, freni parkues elektronik	1.1.22	Lidhjet për kontrollin	2	SISTEMI I DREJTIMIT	3.1	Fusha e shikimit
1.1.7	Valvulat e frenimit (valvulat e këmbës, rregullatori i ajrit, valvula rregulluese)	1.1.23	Sistemi i frenimit me inerci	2.1	Gjendja mekanike	3.2	Gjendja e xhamave
1.1.8	Lidhëset e frenave për rimorkiot (elektrike dhe pneumatike)	1.2	Efektiviteti dhe performanca e frenit të shërbimit	2.1.1	Gjendja e mekanizmit të drejtimit	3.3	Pasqyrat ose pajisjet retrovizore
1.1.9	Ena e presionit për ruajtjen e energjisë	1.2.1	Performanca	2.1.2	Fiksimi i kutisë së mekanizmit të drejtimit	3.4	Fshirëset e xhamave
1.1.10	Përforcuesi i forcës së frenimit (servo), cilindri kryesor (sistemet hidraulike)	1.2.2	Eficienca	2.1.3	Gjendja e lidhjeve në sistemin e drejtimit	3.5	Pastrueset e xhamave

1.1.11	Tubat e ngurtë të frenave					3.6	Sistemi kundër avullimit
4	Dritat, reflektorët dhe pajisjet elektrike	4.4.4	Frekuenca e fleshimiit	4.11	Kabllot elektrike	6.1.1	Gjendja e përgjithshme
4.1	Fenerët kryesorë	4.5	Dritat e përparme dhe të pasme të mjegullës	4.12	Dritat jo të detyrueshme dhe reflektorët	6.1.2	Tubat e shkarkimit dhe silenciatorët
4.1.1	Gjendja dhe funksionimi	4.5.1	Gjendja dhe funksionimi	4.13	Bateria	6.1.3	Serbatori dhe tubat e karburantit (përfshirë ato për ngrohjen e karburantit)
4.1.2	Orientimi	4.5.2	Orientimi	5	Boshtet, rrotat, gomat dhe suspensioni	6.1.4	Mbrojtësit, pajisjet për mbrojtje anësore dhe mbrojtje nga ana e pasme
4.1.3	Çelësi	4.5.3	Çelësi	5.1	Akset	6.1.5	Bartësi i rrotës rezervë
4.1.4	Përputhshmëria me kërkesat	4.5.4	Përputhshmëria me kërkesat	5.1.1	Akset	6.1.6	Pajisja mekanike për lidhje dhe tërheqje
4.1.5	Sistemi për rregullimin e lartësisë së dritave	4.6	Dritat për lëvizjen prapa	5.1.2	Gjysmakset	6.1.7	Transmisioni.
4.1.6	Pajisja për pastrimin e dritave kryesore	4.6.1	Gjendja dhe funksionimi	5.1.3	Kushinetat dhe nyjat drejtuese	6.1.8	Mbajtësit e motorit
4.2	Dritat e përparme dhe të pasme të pozicionit, dritat anësore, dritat gabarite dhe dritat e ditës	4.6.2	Përputhshmëria me kërkesat	5.2	Rrotat dhe gomat	6.1.9	Performanca e motorit
4.2.1	Gjendja dhe funksionimi	4.6.3	Çelësi	5.2.1	Disku i rrotës	6.2	Kabina dhe karroceria
4.2.2	Çelësi	4.7	Drita për ndriçimin e targës së pasme	5.2.2	Rrotat	6.2.1	Gjendja
4.2.3	Përputhshmëria me kërkesat	4.7.1	Gjendja dhe funksionimi	5.2.3	Gomat	6.2.2	Montimi
4.3	Dritat e frenave	4.7.2	Përputhshmëria me kërkesat	5.3	Sistemi i suspensionit	6.2.3	Dyert dhe bravat
4.3.1	Gjendja dhe funksionimi	4.8	Retroreflektorët, shenjat e dukshmërisë dhe pllakat shënuese të pasme	5.3.1	Sustat dhe stabilizuesi	6.2.4	Dyshemeja
4.3.2	Çelësi	4.8.1	Gjendja	5.3.2	Amortizatorët	6.2.5	Ndenjësja e drejtuesit të mjetit
4.3.3	Përputhshmëria me kërkesat	4.8.2	Përputhshmëria me kërkesat	5.3.3	Boshti kardanik, levat, krahët këndor dhe krahët tërthor	6.2.6	Ndenjëset e tjera
4.4	Treguesi i drejtimit dhe dritat sinjalizuese të rrezikut	4.9	Dritat identifikuese të detyrueshme për pajisjet ndriçuese	5.3.4	Nyjat e suspensionit	6.2.7	Pajisjet komanduese për drejtimin e mjetit
4.4.1	Gjendja dhe funksionimi	4.9.1	Gjendja dhe funksionimi	5.3.5	Suspensioni pneumatik	6.2.8	Shkallët e kabinës
4.4.2	Çelësi	4.9.2	Përputhshmëria me kërkesat	6	Shasia dhe elementet e fiksuara në shasi	6.2.9	Pajisjet dhe aksesorët e tjerë të brendshëm dhe të jashtëm

4.4.3	Përputhshmëria me kërkesat	4.10	Lidhjet elektrike mes mjetit tërheqës dhe rimorkio/ gjysmërimorkios	6.1	Shasia ose korniza dhe elementet e fiksuara në shasi	6.2.10	Baltëpritësit, pajisjet kundër spërkatjes
7	PAJISJET E TJERA	7.10	Pajisja për kufizimin e shpejtësisë	9.1.2	Daljet e emergjencës	9.11.1	Dyert, rampat dhe ashensorët
7.1	Rripat e sigurisë/mbërthyes et dhe sistemet e fiksimit	7.11	Odometri	9.1.1	Dyert hyrëse dhe dalëse	9.11.2	Sistemi për fiksimin e karrocave me rrota
7.1.1	Siguria e montimit të rripave të sigurisë/ mbërthyeseve	7.12	Kontrolli Elektronik i Stabilitetit (ESC)	9.2	Sistemi kundër avullimit dhe sistemi kundër ngrirjes	9.11.3	Pajisjet sinjalizuese dhe të posaçme
7.1.2	Gjendja e rripave të sigurisë/ mbërthyeseve	8	Ndikimi në mjedis	9.3	Sistemi i ventilimit dhe sistemi i ngrohjes		
7.1.3	Pajisja për kufizimin e ngarkesës së rripit të sigurimit	8.1	Sistemi për reduktimin e zhurmës	9.4	.Ndenjëset		
7.1.4	Parashtrënguesit e rripit të sigurimit	8.2	Emetimi i gazrave të shkarkimit	9.4.1	Ndenjëset e udhëtarëve		
7.1.5	Jastëkët e ajrit *(airbag)*	8.2.1	Emetimi i gazrave të shkarkimit në motorët me ndezje të komanduar	9.4.2	Ndenjësja e drejtuesit		
7.1.6	Sistemi SRS	8.2.1.1	Pajisja për kontrollin e emetimit të gazrave të shkarkimit	9.5	Dritat e brendshme dhe udhëzimet për udhëtarë		
7.2	Aparati për shuarje të zjarrit	8.2.1.2	Emetimet e gazrave	9.6	Korridoret, hapësira për qëndrim në këmbë të udhëtarëve		
7.3	Brava e derës dhe pajisja kundër vjedhjes	8.2.2	Emetimi i gazrave të shkarkimit në motorët me ndezje të komprimuar	9.7	Shkallët dhe platformat		
7.4	Trekëndëshi i sigurisë	8.2.2.1	Pajisja për kontrollin e emetimit të gazrave të shkarkimit	9.8	Sistemi i komunikimit me udhëtarët		
7.5	Kutia e ndihmës së parë	8.2.2.2	Opaciteti	9.9	Shënimet		
7.6	Pykat e rrotave	8.3	Elemente të tjera të lidhur me mjedisin	9.10	Kërkesa lidhur me transportimin e fëmijëve		
7.7	Boria	8.3.1	Rrjedhje lëngjesh	9.10.1	Dyert		
7.8	Shpejtësimatësi	9	Testime suplementare për automjetet e kategorive M2, M3 që transportojnë udhëtarë	9.10.2	Pajisjet sinjalizuese dhe të posaçme		
7.9	Tahografi	9.1	Dyert	9.11 9.11.1 9.112 9.113	Kërkesa lidhur me transportimin e personave me lëvizshmëri të kufizuar Dyert rampat dhe ashensorët Sisteme fiksimit për karrocat me rrota Pajisjet sinjalizuese dhe të posaçme		

ANEKSI V
FORMA STANDARD PËR RAPORTIM

Formulari standard duhet të hartohet në një format kompjuterik të përpunueshëm dhe të transmetohet me anë të mjeteve elektronike duke përdorur programet standarde të zyrës.

Autoriteti kompetent duhet të hartojë:

- një tabelë të vetme përmbledhëse; dhe
- për secilin shtet të regjistrimit të mjeteve të kontrolluara në një inspektim më të detajuar, një tabelë e detajuar e veçantë që përmban informacion mbi defektet e kontrolluara dhe të zbuluara për secilën kategori të mjeteve.

TABELË PËRMBLEDHËSE E TË GJITHA KONTROLLEVE TEKNIKE (FILLESTARE DHE MË TË DETAJUARA)

Periudha raportuese viti [X] deri në vitin [X+1]																		
Kategoria e mjetit **Vendi i regjistrimit**	**N_2**		**N_3**		**M_2**		**M_3**		**O_3**		**O_4**		**T5**		**Kategori të tjera (opsionale)**		**Totali**	
	Numri i mjeteve të kontrolluara	**Numri i mjeteve që nuk e kanë kaluar kontrollin** (1)	**Numri i mjeteve të kontrolluara**	**Numri i mjeteve që nuk e kanë kaluar kontrollin**	**Numri i mjeteve të kontrolluara**	**Numri i mjeteve që nuk e kanë kaluar kontrollin**	**Numri i mjeteve të kontrolluara**	**Numri i mjeteve që nuk e kanë kaluar kontrollin**	**Numri i mjeteve të kontrolluara**	**Numri i mjeteve që nuk e kanë kaluar kontrollin**	**Numri i mjeteve të kontrolluara**	**Numri i mjeteve që nuk e kanë kaluar kontrollin**	**Numri i mjeteve të kontrolluara**	**Numri i mjeteve që nuk e kanë kaluar kontrollin**	**Numri i mjeteve të kontrolluara**	**Numri i mjeteve që nuk e kanë kaluar kontrollin**	**Numri i mjeteve të kontrolluara**	**Numri i mjeteve që nuk e kanë kaluar kontrollin**
Shqipëria																		
Belgjika																		
Bullgaria																		
Etj.																		

1. Mjete që nuk e kalojnë kontrollin me defekte të mëdha ose të rrezikshme sipas aneksit IV.

REZULTATET E KONTROLLEVE TEKNIKE MË TË DETAJUARA

Vendi i regjistrimit: P.sh., Belgjika, periudha nga 1/viti [x] deri 12/viti [x+1]

Emri i vendit të regjistrimit të mjetit																		
Kategoria e mjetit:	**N_2**		**N_3**		**M_2**		**M_3**		**O_3**		**O_4**		**T5**		**Kategori të tjera (opsionale)**		**Totali**	
	Numri i mjeteve të kontrolluara	**Numri i mjeteve që nuk kalojnë kontrollin[1]**	**Numri i mjeteve të kontro-lluara**	**Numri i mjeteve që nuk e kanë kaluar kontrollin**	**Numri i mjeteve të kontrolluara**	**Numri i mjeteve që nuk e kanë kaluar kontrollin**	**Numri i mjeteve të kontrolluara**	**Numri i mjeteve që nuk e kanë kaluar kontrollin**	**Numri i mjeteve të kontro-lluara**	**Numri i mjeteve që nuk e kanë kaluar kontrollin**	**Numri i mjeteve të kontro-lluara**	**Numri i mjeteve që nuk e kanë kaluar kontrollin**	**Numri i mjeteve të kontro-lluara**	**Numri i mjeteve që nuk kalon kontrollin**	**Numri i mjeteve të kontrolluara**	**Numri i mjeteve që nuk e kanë kaluar kontrollin**	**Numri i mjeteve të kontrolluara**	**Numri i mjeteve që nuk e kanë kaluar kontrollin**
Detaje të defektit																		
	Kontrolluar	Nuk kalon	Kontrolluar	Nuk kalon	Kontrolluar	Nuk kalon	Kontrolluar	Nuk kalon	Kontrolluar	Nuk kalon	Kontrolluar	Nuk kalon	Kontrolluar	Nuk kalon	Kontrolluar	Nuk kalon	Kontrolluar	Nuk kalon
(0) Identifikimi																		
(1) Pajisjet e frenimit																		
(2) Sistemi i drejtimit																		
(3) Shikueshmëria																		
(4) Pajisjet e ndriçimit dhe sistemit elektrik																		
(5) Boshtet, rrotat, gomat, suspensioni																		
(6) Shasia dhe pjesët e shasisë																		
(7) Pajisje të tjera përfshirë tahografin dhe kufizues të shpejtësisë																		
(8) Ndikimi në mjedis përfshirë emetimet dhe rrjedhjet e karburantit dhe/ose vajit																		
(9) Teste shtesë për M2/M3																		

(10) Sigurimi i ngarkesës																		
Detaje të defekteve (shtesë)																		
1.1.1																		
1.1.2																		
…																		
2.1.1																		
2.1.2																		
…																		
3.1																		
3.2																		
…																		
20.6.2																		
30																		
Numri total i mjeteve që nuk kanë kaluar kontrollin																		

1. Mjete që nuk kanë kaluar defekte të mëdha ose të rrezikshme, sipas aneksit IV.

URDHËR
Nr. 164, datë 10.6.2020

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PROCEDURAT E PLOTËSIMIT TË VENDEVE VAKANTE SI NOTER

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar; të nenit 11, pika 5, të ligjit nr. 110/2018, "Për noterinë",

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullave për procedurat e plotësimit të vendeve vakante si noter, sipas përcaktimeve të këtij urdhri.

2. Çdo vend vakant i krijuar plotësohet sipas radhës së mëposhtme:

a) nëpërmjet transferimit të një noteri që ka kërkuar transferim në këtë pozicion;

b) nëpërmjet dhënies së licencës së noterit një zëvendësnoteri, që ka shprehur interesin për vendin e ri vakant;

3. Ministria e Drejtësisë kryen evidentimin e vendeve vakante si noter dhe përgatit listën përkatëse, sipas bashkive ku janë evidentuar vakancat.

4. Shpallja e çdo vendi vakant kryhet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare dhe në faqen zyrtare të ministrisë dhe të Dhomës Kombëtare të Noterisë, jo më vonë se 30 ditë nga data e krijimit të pozicionit, shoqëruar me dokumentacionin që duhet t'i bashkëlidhet kërkesës.

5. Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë, në Ministrinë e Drejtësisë, organizon punën për regjistrimin e kërkesave dhe informon të interesuarit lidhur me afatin për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm që i bashkëlidhet kërkesës.

6. Noteri paraqet kërkesë me shkrim pranë ministrit të Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, për transferimin e veprimtarisë noteriale brenda 30 ditëve nga publikimi i vendeve vakante në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, faqen zyrtare të Ministrinë së Drejtësisë dhe të Dhomës Kombëtare të Noterisë, duke përcaktuar dhe preferencën gjeografike për vendin vakant për të cilin shpreh interesin.

7. Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë, brenda 10 ditëve kryen verifikimin e kushteve ligjore të noterëve që kërkojnë transferim dhe brenda 15 ditëve nga përfundimi i afatit 30- ditor për paraqitjen e kërkesës, harton listën e cila duhet të përmbajë emrat e noterëve që kanë shprehur interesin për transferim dhe plotësojnë kriteret, si dhe bashkitë në të cilat dëshirojnë të transferohen. Lista duhet të jetë e nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë.

8. Noteri, i cili paraqet kërkesë për transferimin e veprimtarisë noteriale duhet të ketë ushtruar për jo më pak se 5 vjet veprimtarinë në juridiksionin ekzistues dhe me kusht që në momentin e transferimit të jetë jo më shumë se 65 vjeç dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi ndaj tij.

9. Në rastin e kandidatëve që aplikojnë për transferim në të njëjtën degë vendore dhe që plotësojnë kriteret ligjore, fitues shpallet kandidati me vjetërsi më të madhe në profesion.

10. Në rastin e kandidatëve që aplikojnë për transferim në të njëjtën degë vendore, që plotësojnë kriteret ligjore dhe që kanë të njëjtën vjetërsi pune në profesion, fitues shpallet kandidati vendbanimi i të cilit ndodhet më pranë bashkisë ku është evidentuar vendi vakant.

11. Ministri i Drejtësisë urdhëron transferimin e veprimtarisë së noterit brenda 30 ditëve nga përfundimi i afatit për paraqitjen e shprehjes së interesit, nëse plotësohen kriteret për transferim, të përcaktuara në ligjin nr. 110/2018, "Për noterinë".

12. Noterët, të cilët nuk përmbushin kushtet dhe kriteret ligjore për transferimin e veprimtarisë noteriale, informohen në adresën e tyre postare nga Ministria e Drejtësisë, mbi arsyet e refuzimit.

13. Vendi vakant, që nuk mund të plotësohet nëpërmjet transferimit, për shkak të mungesës së kërkesave apo mosplotësimit të kushteve ligjore, plotësohet nëpërmjet dhënies së licencës një zëvendësnoteri.

14. Zëvendësnoteri paraqet kërkesë me shkrim pranë ministrit të Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, brenda 30 ditëve nga publikimi i vendeve vakante në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomën Kombëtare të Noterisë, duke përcaktuar dhe preferencën gjeografike për vendin vakant për të cilin shpreh interesin.

15. Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë, brenda 10 ditëve, kryen verifikimin e kushteve ligjore të zëvendësnoterëve që shprehin interes për t'u licencuar si noter dhe brenda 15 ditëve nga përfundimi i afatit 30-ditor për paraqitjen e kërkesës harton listën e cila duhet të përmbajë emrat e zëvendësnoterëve që shprehin interesin për t'u licencuar si noter. Lista duhet të jetë e nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë.

16. Në rastin e zëvendësnoterëve që aplikojnë për marrjen e licencës si noter dhe që plotësojnë kriteret ligjore, fitues shpallet kandidati me vjetërsi më të madhe në profesion.

17. Në rastin e zëvendësnoterëve me vjetërsi pune të barabartë, licenca i jepet aplikuesit me më shumë pikë në provimin e kualifikimit.

18. Në rastin e zëvendësnoterëve që aplikojnë për marrjen e licencës si noter, që plotësojnë kriteret ligjore, kanë të njëjtën vjetërsi pune në profesion dhe pikë të barabarta në provimin e kualifikimit, fitues shpallet kandidati që ka vendbanimin apo që vendbanimi i të cilit ndodhet më pranë bashkisë ku është evidentuar vendi vakant.

19. Ministri i Drejtësisë urdhëron dhënien e licencës zëvendësnoterit brenda 30 ditëve nga përfundimi i afatit për paraqitjen e shprehjes së interesit, nëse plotësohet kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 110/2018, "Për noterinë".

20. Zëvendësnoterët që nuk përmbushin kushtet dhe kriteret ligjore për transferimin e veprimtarisë noteriale, informohen në adresën postare nga Ministria e Drejtësisë mbi arsyet e refuzimit.

21. Kundër vendimit të ministrit të Drejtësisë, zëvendësnoteri ka të drejtë ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

22. Në rast se nuk paraqiten shprehje interesi nga zëvendësnoteri, ministri i Drejtësisë, brenda 20 ditëve mund t'i kërkojë zëvendësnoterit me vjetërsinë më të madhe në profesion që plotëson kushtet dhe që ushtron funksionin brenda zonës ku shtrin kompetencën e saj tokësore gjykata e apelit të juridiksionit të zakonshëm, të aplikojë për një vend vakant që nuk është plotësuar dhe në rast refuzimi procedohet, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 110/2018, "Për noterinë".

23. Në rast se zëvendësnoteri i përgjigjet thirrjes për shprehje interesi, duke aplikuar për një vend vakant dhe plotëson kriteret ligjore, ministri i Drejtësisë urdhëron dhënien e licencës zëvendësnoterit, brenda 30 ditëve nga përfundimi i afatit për paraqitjen e shprehjes së interesit.

24. Për zëvendësnoterët që refuzojnë aplikimin në një nga vendet vakante, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë harton një listë, e cila nënshkruhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë.

25. Ministria e Drejtësisë i përcjell Dhomës Kombëtare të Noterisë listën e zëvendësnoterëve që përjashtohen nga e drejta për shprehje interesi, për një vend vakant si noter për një periudhë 2-vjeçare.

26. Shtetasi i pajisur me licencën e ushtrimit të profesionit të noterit nga ministri i Drejtësisë fillon ushtrimin e veprimtarisë noteriale në vendin e shpallur vakant, jo më vonë se 60 ditë nga data e lëshimit të licencës. Me kalimin e këtij afati, sipas njoftimit nga Dhoma Kombëtare e Noterisë ose nga vetë i interesuari, licenca e ushtrimit të shërbimit të noterisë shfuqizohet dhe ministri i Drejtësisë, në bazë të renditjes së aplikantëve në listën e pritjes, emëron një aplikant tjetër në atë pozicion.

27. Në rast se edhe ky i fundit nuk e fillon ushtrimin e veprimtarisë së tij noteriale, brenda afatit 60-ditor, zhvillohet një garë e re për të plotësuar vendin vakant.

28. Kandidati, që pas emërimit nuk fillon aktivitetin, mund të pezullohet nga shprehja e interesit me vendim të Këshillit të Dhomës, për një periudhë prej një deri në pesë vjetësh.

29. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë.

30. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

URDHËR
Nr. 165, datë 10.6.2020

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PUNËSIMIN E KANDIDATËVE PËR NOTER

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, dhe të nenit 8, pika 8, të ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë",

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullave më të hollësishme mbi punësimin e kandidatëve për noter, si dhe veprimtarisë gjatë periudhës së angazhimit si kandidat pranë noterit.

2. Çdo person që plotëson kushtet e parashikuara në shkronjat "a", "b", "c", "ç", dhe "d", dh, të nenit 5, të ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", mund të bëhet kandidat për noter.

3. Noteri depoziton në Dhomën Kombëtare të Noterisë dhe në Ministrinë e Drejtësisë një kopje të kontratës dhe dokumentacionin ligjor të kërkuar për kandidatët për noterë, brenda 15 ditëve nga momenti i lidhjes së saj me kandidatin për noter.

4. Kandidati për noter regjistrohet në regjistrin përkatës të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe depoziton dokumentacionin e kërkuar, jo më vonë se 30 ditë nga data e fillimit të punës si kandidat për noter pranë një noteri.

5. Kandidati për noter paraqet pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe të Dhomës Kombëtare të Noterisë dokumentet e mëposhtme:

a) 2 fotografi;

b) certifikatë personale e marrë jo më herët se tre muajt e fundit;

c) kopjen e dokumentit të identifikimit (pasaportë apo letërnjoftim ID);

d) vërtetimin nga organet e pushtetit vendor lidhur me vendbanimin;

e) kopjen e diplomës së nivelit *Bachelor* dhe diplomës "Master i shkencave" të Fakultetit të Drejtësisë ose diplomë të njësuar me të, ose studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit, të njësuara në përputhje me rregullat për njësimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi, të shoqëruara me certifikatat e notave;

f) formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore, i plotësuar;

g) vërtetimin nga gjykata dhe prokuroria e vendbanimit se nuk është subjekt në proces për vepra penale;

h) kopjen e librezës së punës;

i) kopjen e kontratës të lidhur mes tij dhe noterit pranë të cilit do të qëndrojë si kandidat për noter;

j) certifikatën e kalimit me sukses të provimit të pranimit në formimin fillestar.

6. Dokumentacioni i paraqitur pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Ministrisë së Drejtësisë shqyrtohet brenda 15 ditëve nga administrimi dhe në rast se, konstatohet se dokumentacioni nuk është i plotë, kandidatit për noter i lihet një afat 10-ditor për plotësim.

7. Kandidati për noter lidh një kontratë punësimi me një noter, i cili ka jo më pak se 5 vjet përvojë pune si noter.

8. Kandidati për noter mund të lidhë kontratë me një noter me moshë maksimale deri në 67 vjeç dhe me të cilin nuk është bashkëshort ose i afërt deri në shkallë të dytë.

9. Në rast se gjatë kohës që personi qëndron si kandidat për noter, noteri transferohet në një degë tjetër vendore ose ndaj tij jepet një nga masat disiplinore të parashikuara nga neni 26, germat "ç", "d", "dh", të ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", kandidati nuk mund të qëndrojë më si i tillë pranë këtij noteri. Brenda 2 muajsh nga dita kur masa disiplinore e dhënë është ekzekutuar, kandidati për noter duhet të lidhë kontratë me një noter tjetër të së njëjtës degë vendore për periudhën e mbetur dhe një kopje të saj dërgohet në Ministrinë e Drejtësisë dhe në Dhomën Kombëtare të Noterisë.

10. Në rast se masa disiplinore e dhënë është ankimuar nga noteri dhe nuk ka përfunduar shqyrtimi i saj administrativ ose gjyqësor, kandidati për noter do të vijojë të qëndrojë pranë këtij noteri deri sa të përfundojë procesi dhe masa të marrë formë të prerë.

11. Në rast se gjatë periudhës së qëndrimit si kandidat për noter sëmuret për një afat pa ndërprerje nga 20 ditë deri në 5 muaj, periudha e mëparshme si kandidat njihet, por koha e qëndrimit si kandidat zgjatet për aq kohë sa ai ka qenë i sëmurë.

12. Në rast se kandidati për noter ka qenë i sëmurë për një kohë më të gjatë se 5 muaj periudha e qëndrimit si kandidat nuk do t'i njihet nëse është më e shkurtër se 1 vit, por ai ka të drejtë të qëndrojë si kandidat duke rifilluar përllogaritja e afatit nga e para. Paraprakisht, kandidati vë në dijeni dhe i paraqet vërtetimin nga institucionet e shërbimit shëndetësor, Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, të cilat bëjnë shënimet përkatëse në regjistra dhe shtesat në dokumentacionin e dosjes personale të tij.

13. Në rast se gjatë periudhës që personi do të qëndrojë si kandidat nuk paraqitet në zyrën noteriale ku është punësuar për një periudhë në vazhdim më të gjatë se 30 ditë, pa asnjë arsye, atëherë koha që ai ka qëndruar si kandidat nuk do t'i njihet për efekt të konkurrimit dhe plotësimi i saj nuk mund të bëhet.

14. Në rast se mungesat pa arsye janë për një kohë më të shkurtër se 30 ditë, ato gjatë gjithë periudhës 2-vjeçare nuk mund të jenë më shumë se 3 muaj në total. Në rast të kundërt koha e qëndrimit si kandidat nuk do të njihet për efekt të konkurrimit, plotësimi i saj nuk mund të bëhet dhe ai nuk mund të vijojë më të qëndrojë si kandidat pranë noterit.

15. Kur nuk janë kushtet e mosnjohjes së periudhës si kandidat sipas paragrafëve të mësipërm, qëndrimi si kandidat zgjatet deri sa të plotësohet afati 2-vjeçar.

16. Kandidatët për noter qëndrojnë në zyrë dhe nën drejtimin e noterit, ndjekin veprimtarinë e zyrës, për një kohë jo më të shkurtër se 8 orë në ditë. Orari i qëndrimit caktohet në kontratën e lidhur mes kandidatit dhe noterit dhe mospërcaktimi i fashës së orarit përbën shkak konsiderimin e aktit me të meta. Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe Ministria e Drejtësisë kërkojnë plotësimin e kontratës brenda 10 ditëve.

17. Në rast se kandidati nuk e respekton orarin e parashikuar më sipër, noteri vë në dijeni Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomën Kombëtare të Noterisë, të cilat shqyrtojnë rastin dhe kur shkelja vlerësohet e rëndë dhe e përsëritur, Ministria e Drejtësisë e paralajmëron për ndërprerje të procesit të qëndrimit si kandidat për noter dhe bën shënimet në regjistrin e kandidatëve.

18. Në rast se kandidati vijon të mos e respektojë orarin, ndaj tij merret masa e ndërprerjes së kohës së qëndrimit për një afat deri 50 ditë të cilat konsiderohen si mungesa pa arsye, zgjatet koha e qëndrimit si kandidat dhe do të veprohet sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje. Kjo masë pasqyrohet në regjistrin e kandidatëve. Kur mosrespektimi i orarit ndodh edhe pas masave të mësipërme, Ministria e Drejtësisë bën çregjistrimin e kandidatit nga regjistri përkatës dhe mbylljen e dosjes së tij, duke njoftuar edhe Dhomën Kombëtare të Noterisë.

19. Gjatë periudhës së trajnimit praktik pranë noterit me të cilin ka nënshkruar kontratën, kandidati për noter shkëputet nga çdo marrëdhënie tjetër pune, përveç asaj shkencore e mësimdhënëse, me synim rritjen e kualifikimit të tij profesional.

20. Marrëdhënia e punës ndërmjet kandidatit për noter dhe noterit pranë të cilit punon është me kohë të plotë dhe rregullohet sipas parashikimeve të Kodit të Punës dhe legjislacionit në fuqi për sigurimet shoqërore.

21. Noteri siguron që të gjithë kandidatët e punësuar pranë tij marrin një trajnim të përshtatshëm dhe gjithëpërfshirës praktik. Nën mbikëqyrjen dhe drejtimin e noterit, kandidatët fitojnë njohuri dhe aftësi praktike mbi të gjitha aspektet e veprimtarisë noteriale, mbi fushat e së drejtës të lidhura me noterinë, si dhe njihen me rregullat etiko-profesionale të profesionit.

22. Kandidatët për noter asistojnë noterin lidhur me veprimtarinë noteriale por nuk mund të kryejnë punë ngushtësisht personale me cilësinë e noterit.

23. Puna e kandidatit për noter vlerësohet nga noteri përgjegjës për çdo vit kalendarik duke marrë në konsideratën dhe etikën e treguar gjatë angazhimit në zyrën noteriale.

24. Vlerësimi dorëzohet pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë, dhe Ministrisë së Drejtësisë jo më vonë se 31 janari i çdo viti.

25. Brenda 30 ditësh pas përfundimit të periudhës 2-vjeçare, noteri jep mendim me shkrim lidhur me aftësitë profesionale. Ky mendim i dërgohet i mbyllur në zarf Ministrisë së Drejtësisë, e cila e depoziton në dosjen e kandidatit. Ministria e Drejtësisë i jep të interesuarit konfirmimin e periudhës së qëndrimit si kandidat për noter.

26. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë, noterët dhe kandidatët për noter.

27. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

URDHËR
Nr. 166, datë 10.6.2020

PËR FORMËN, PËRMBAJTJEN DHE KARAKTERISTIKAT E TJERA TË VULAVE, SI DHE RREGULLAT PËR PAJISJEN DHE ADMINISTRIMIN E TYRE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë se Drejtësisë", të ndryshuar, të nenit 69, pika 4, të ligjit nr. 110/2018, "Për noterinë",

URDHËROJ:

1. Noteri për ushtrimin e veprimtarisë së tij duhet të jetë i pajisur me vulën e thatë dhe vulën e njomë.

2. Vula e thatë ka formë rrethore, me diametër 50 mm, e konturuar nga një rreth. Brenda saj është konturuar një rreth më i vogël me diametër 30 mm. Në hapësirën ndërmjet rrethit të brendshëm dhe të rrethit të jashtëm të vulës janë shkruar në formë të harkuar me shkronja të mëdha fjalët "REPUBLIKA E SHQIPËRISË". Poshtë tyre, në formë të harkuar në të kundërt të fjalëve të mësipërme, është shkruar emri i bashkisë ku zhvillon veprimtarinë noteri.

Në hapësirën brenda rrethit të vogël, të renditura poshtë fjalëve "REPUBLIKA E SHQIPËRISË", janë shkruar në formë të harkuar, me shkronja të mëdha, emri, shkronja e parë e emrit të babait dhe mbiemri i noterit. Në mes të rrethit të vogël është konturuar shqiponja dykrenare dhe poshtë saj, në formë të harkuar në të kundërt të emrit e mbiemrit të noterit është shkruar me shkronja të mëdha fjala "NOTER".

3. Vula e njomë ka formë rrethore me diametër 35 mm. Brenda saj janë shkruar në formë të harkuar me shkronja të mëdha fjalët "REPUBLIKA E SHQIPËRISË". Poshtë tyre me shkronja të mëdha, por më të vogla si madhësi, në një rresht të dytë në formë të harkuar vendoset emri, shkronja e parë e emrit të babait dhe mbiemri i noterit. Në mes konturohet shqiponja dykrenare dhe poshtë saj në formë të harkuar në të kundërt të emrit dhe të mbiemrit të noterit është shkruar me shkronja të mëdha, por të së njëjtës madhësi me ato të emrit, fjala "NOTER". Poshtë kësaj fjale, me shkronja të mëdha, por të së njëjtës madhësi me ato të fjalëve "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" dhe në formë të harkuar në të kundërt me to, është shkruar emri i qytetit ku zhvillon veprimtarinë noteri.

4. Përgatitja e vulave bëhet nga subjekte shtetërore të specializuara dhe kur kjo nuk është e mundur nga subjekte private shqiptare ose të huaja, që e ushtrojnë veprimtarinë e përgatitjes së vulave me leje të nxjerrë nga organet kompetente.

5. Personi, që merr për herë të parë licencën për ushtrimin e profesionit të noterit, noteri që transferohet, noteri, të cilit i janë dëmtuar vulat dhe noteri, të cilit i kanë humbur vulat, i paraqesin kërkesën për t'u pajisur me vula Dhomës Kombëtare të Noterisë. Kërkesa duhet të jetë e shoqëruar me konfirmimin e Ministrisë së Drejtësisë se personi lejohet të pajiset me vulat e noterit, si dhe me të dhënat e nevojshme për përgatitjen e vulave.

6. Në rastin e vulave të reja, për shkak se kanë humbur të mëparshmet, matrica e vulës së re duhet të ketë detyrimisht një vendosje të ndryshme topografike të mbishkrimeve të saj, që e bëjnë të dallueshme nga vula e mëparshme.

7. Pasi janë përgatitur, vulat i dorëzohen përfaqësuesit të caktuar nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, në prani edhe të personit të ngarkuar nga ministri i Drejtësisë. Vulat merren në dorëzim me procesverbal të firmosura nga të dy përfaqësuesit e përmendur më sipër dhe depozitohen për ruajtje pranë Ministrisë së Drejtësisë. Vulat ruhen dhe nuk përdoren deri në ceremoninë e betimit, kur do t'i dorëzohen noterit.

8. Në rastin e vulave të reja të noterëve që u janë zëvendësuar vulat, për arsye se u kanë humbur ose u janë dëmtuar, ato i paraqiten drejtorit të drejtorisë përgjegjëse për veprimtarinë e noterisë në

Ministrinë e Drejtësisë apo personit të ngarkuar prej tij, i cili, pasi i verifikon, i kërkon noterit t'i firmosë dhe t'i vulosë, me vulat që do të përdorë, fletë të bardha format "A4". Këto fletë nevojiten për t'u depozituar në dosjen personale dhe për t'iu dërguar institucioneve të ndryshme shtetërore si model krahasues. Për këtë procedurë hartohet procesverbali përkatës dhe më pas vulat i dorëzohen noterit.

9. Procedurat e përgatitjes së vulave nga Dhoma Kombëtare e Noterisë duhet të përfundojnë brenda 40 ditëve nga dita e lëshimit të licencës së ushtrimit të profesionit të noterit.

10. Në rast të mosrespektimit të afatit të sipërpërmendur nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, procesi i përgatitjes së vulave drejtohet dhe organizohet nga Ministria e Drejtësisë, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë urdhër.

11. Pajisja e noterit me vula bëhet nga Dhoma Kombëtare e Noterisë në ambientet dhe në prani të përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë, në çastin kur bën betimin.

12. Ministria e Drejtësisë njofton me shkrim Dhomën Kombëtare të Noterisë 10 ditë përpara për ditën dhe orën e kryerjes së ceremonisë së betimit, si dhe për pjesëmarrësit dhe i kërkon caktimin e përfaqësuesve që do të drejtojnë procesin e pajisjes me vula. Në rast mosparaqitjeje pa arsye, ceremonia zhvillohet pa pjesëmarrjen e tyre dhe noterëve të rinj u dorëzohen vulat, duke pasqyruar në procesverbal gjithë veprimtarinë.

13. Në rastin e noterëve të transferuar ose të cilëve u jepet vula pas përfundimit të kohës së pezullimit nga detyra, Ministria e Drejtësisë njofton me shkrim Dhomën Kombëtare të Noterisë për detyrimin e drejtimit të procesit dhe për të caktuar përfaqësuesit e saj 10 ditë përpara ditës kur noterëve do t'u dorëzohet vula.

14. Nëse përfaqësuesit e Dhomës Kombëtare të Noterisë nuk mund të marrin pjesë në proces për arsye objektive, procesi i dorëzimit të vulave do të zhvillohet një ditë tjetër, por jo më vonë se 15 ditë nga dita e caktuar më parë. Në rast se mospjesëmarrja e përfaqësuesve të Dhomës Kombëtare të Noterisë është e pajustifikueshme, si dhe kur edhe pas caktimit të një date tjetër, si më sipër, përfaqësuesi i Dhomës Kombëtare të Noterisë nuk mund të marrë pjesë, vulat u dorëzohen noterëve nga përfaqësuesit e Ministrisë se Drejtësisë, duke pasqyruar gjithçka në procesverbalin përkatës.

15. Për pajisjen me vulë mbahet një procesverbal, i cili nënshkruhet nga përfaqësuesi i Dhomës Kombëtare të Noterisë, drejtori i drejtorisë përgjegjëse për veprimtarinë e profesioneve të lira në Ministrinë e Drejtësisë dhe nga noteri. Procesverbali pasqyron kohën, vendin, emrin e pjesëmarrësve dhe faktin e marrjes së vulës në dorëzim nga noteri. Procesverbali nënshkruhet nga personat e sipërpërmendur, duke i dhënë një kopje të tij Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe një kopje depozitohet në Ministrinë e Drejtësisë.

16. Drejtori i drejtorisë përgjegjëse për veprimtarinë e noterisë në Ministrinë e Drejtësisë kërkon nga personat të firmosin dhe të vulosin me vulat e reja në fletë të bardha format "A4", të cilat nevojiten për t'u depozituar në dosjen personale dhe për t'iu dërguar institucioneve të ndryshme shtetërore si model krahasues.

17. Institucioneve qendrore më të rëndësishme, si dhe subjekteve të tjera që vlerësohen nga Ministri i Drejtësisë se kanë lidhje të ngushtë me veprimtarinë e noterisë u dërgohet zyrtarisht, për çdo noter, një fletë e bardhë e nënshkruar dhe e vulosur me vulat e tij.

18. Në çdo rast, modeli i vulave, emri dhe firma e çdo noteri i dërgohet për depozitim e model ministrisë përgjegjëse për rendin publik, ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme, prokurorive dhe gjykatave.

19. Noteri i pajisur me vulë është i detyruar të kujdeset për ruajtjen e saj nga dëmtimet, vjedhjet dhe përdorimin nga të tretët.

20. Vula është personale dhe përdoret vetëm nga noteri dhe në rastet e përcaktuara në ligj nga zëvendësnoteri. E drejta për të përdorur vulën nuk mund t'i jepet në asnjë rrethanë të tretëve.

21. Në rast se gjatë kontrolleve konstatohet se vula e noterit përdoret nga persona të tretë, me përjashtim të zëvendësnoterit, përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë të ngarkuar me kontrollin, pasqyrojnë faktin në procesverbalin përkatës.

22. Në rast se shkelet detyrimi i ruajtjes dhe i përdorimit të vulës, ndaj noterit dhe/ose zëvendësnoterit, në varësi të rëndësisë së shkeljes së konstatuar, Ministria e Drejtësisë dhe/ose Bordi Disiplinor i Noterëve ka të drejtë të marrë një nga masat disiplinore, sipas parashikimeve përkatëse të ligjit për noterinë.

23. Akti ose veprimi noterial është i pavlefshëm, në rast se nuk përmban vulën e thatë pranë emrit të noterit dhe vulën e njomë në lidhjen e dokumenteve dhe/ose mbi pullën e taksës. Kur dokumenti ka shumë fletë, ato lidhen zakonisht në cepin e majtë sipër ose në anën e majtë dhe duke u përthyer një nga një në vendin e lidhjes vulosen me vulën e njomë, forma e së cilës del pjesërisht në çdo fletë. Në rast se dokumenti ka shumë fletë dhe ato nuk mund të lidhen me vulë si më sipër, vihet nga një vulë e njomë në çdo faqe të shkruar dhe në vërtetim shënohet numri i faqeve të shkruara kur nuk janë të numërtuara.

24. Urdhri nr. 8045, datë 2.12.2004 i ministrit të Drejtësisë, "Për formën, përmbajtjen, karakteristikat dhe rregullat e pajisjes dhe administrimit të vulave të noterëve", të ndryshuar, shfuqizohet.

25. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë, noterët dhe zëvendës-noterët.

26. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

URDHËR
Nr. 167, datë 10.6.2020

PËR MARRJEN NË DORËZIM TË AKTEVE NOTERIALE, REGJISTRAVE DHE VULAVE TË NOTERIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar dhe të nenit 72, pika 5, të ligjit nr. 110/2018, "Për noterinë",

URDHËROJ:

1. Në rastet kur noteri ka ndërruar jetë ose ndaj tij është zbatuar masa disiplinore pezullim nga detyra, për një periudhë nga një deri në pesë vjet, ose masa disiplinore e heqjes përfundimtare të licencës për ushtrimin e profesionit të noterit, regjistrat, aktet noteriale dhe vulat merren në dorëzim nga një person i autorizuar nga ministri i Drejtësisë dhe dega përkatëse vendore e dhomës, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në këtë urdhër.

2. Ministri i Drejtësisë përcakton me urdhër ngritjen e një komisioni për marrjen në dorëzim të regjistrave, akteve noteriale dhe vulave me përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë dhe Dega Vendore e Noterisë, anëtar i së cilës ishte noteri.

3. Për marrjen e regjistrave, akteve noteriale dhe vulave, personi (ish-noteri; personi i ngarkuar prej tij përmes prokurës së posaçme apo personi që ka në ruajtje arkivin), njoftohet të paktën 5 ditë përpara për ditën dhe orën e dorëzimit dhe i jepet edhe një kopje e urdhrit të ministrit përmes shërbimit postar dhe/ose në rrugë elektronike.

4. Kur personit nuk i dihet vendbanimi, si dhe kur njoftimi nuk mund të kryhet në asnjë prej vendeve të përcaktuara në nenin 151 të Kodit të Procedurës Administrative, kryhet njoftimi publik sipas parashikimit të nenit 162 të Kodit të Procedurës Administrative.

5. Komisioni i marrjes në dorëzim të arkivës merr në dorëzim, me procesverbal të nënshkruar nga të gjithë anëtarët dhe noteri, regjistrat dhe aktet noteriale të arkivit të noterit dhe vulat përkatëse.

6. Pasi regjistrat dhe aktet noteriale janë marrë në dorëzim nga përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë dhe nga përfaqësuesi i degës përkatëse të noterisë, ai i dorëzohet me procesverbal një noteri të së njëjtës degë dhe që ushtron aktivitetin në një zyrë të ndodhur në të njëjtën bashki. Kur nuk ka një zyrë tjetër në atë bashki, arkivi i dorëzohet një noteri të një zyre të ndodhur në bashkinë më të afërt.

7. Kur ndaj noterit është dhënë masë disiplinore për heqje të licencës apo ka ndërruar jetë, vulat nxirren jashtë përdorimit me procesverbal nga një komision i përcaktuar me urdhër të ministrit të Drejtësisë ku përfshihet një nëpunës i Ministrisë së Drejtësisë, një anëtar i degës vendore ku noteri ka qenë anëtar, si dhe një përfaqësues nga Dhoma Kombëtare e Noterisë.

8. Kur ndaj noterit është dhënë masë disiplinore pezullim nga detyra për një periudhë nga një deri në pesë vjet, komisioni i marrjes në dorëzim të arkivës merr në dorëzim, me procesverbal, vulën e

njomë dhe vulën e thatë të noterit me qëllim ruajtjen në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë.

9. Në rast se regjistrat, aktet noteriale dhe vulat janë marrë përkohësisht (kur është dhënë masa disiplinore për pezullim nga detyra për një periudhë nga një deri në 5 vjet) pas përfundimit të periudhës së pezullimit, nxirret urdhër për dorëzimin e arkivit, noterit që e ka pasur. Noteri merr arkivin, me procesverbal, nga noteri që e kishte gjatë kësaj kohe, në prezencë të një përfaqësuesi të Ministrisë së Drejtësisë dhe Degës Vendore të Noterisë. Noterit i dorëzohen, me procesverbal, në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë, vulat noteriale.

10. Në rast moszbatimi vullnetar, urdhri i ministrit të Drejtësisë për dorëzimin e akteve noteriale të arkivit të noterit, regjistrave dhe vulave të përmendura në këtë urdhër, përbën titull ekzekutiv.

11. Ministria e Drejtësisë merr masa për ndjekjen e procedurave ligjore për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit mbi titullin ekzekutiv. Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë i kërkon sektorit të përfaqësimit gjyqësor në Ministrinë e Drejtësisë paraqitjen e kërkesës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit. Sektori i përfaqësimit gjyqësor paraqet në gjykatë kërkesën, brenda 20 ditëve nga përfundimi i afatit të përcaktuara në pikën 3 dhe 4, të këtij urdhri. Pas lëshimit të urdhrit të ekzekutimit Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë i kërkon zyrës së përmbarimit shtetëror vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv.

12. Komisioni i marrjes në dorëzim të arkivës merr në dorëzim, me procesverbal të nënshkruar nga të gjithë anëtarët dhe noteri, regjistrat dhe aktet noteriale, pjesë të arkivit të noterit dhe vulat përkatëse.

13. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet struktura përgjegjëse për profesionet e lira në Ministrinë e Drejtësisë.

14. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

URDHËR
Nr. 168, datë 10.6.2020

PËR EVIDENTIMIN DHE MARRJEN NË DORËZIM TË ARKIVAVE TË PADORËZUAR NDËR VITE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, të nenit 142, pika 10, të ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë",

URDHËROJ:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë kryen verifikimin në regjistrin e noterëve, duke evidentuar në një listë të gjithë noterët të cilëve iu është hequr licenca e ushtrimit të profesionit të noterit dhe për të cilët në regjistër nuk ka të dhëna mbi noterin që ka marrë në dorëzim arkivin.

2. Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë kryen verifikimet përkatëse dhe nxjerr nga arkiva të gjithë urdhrat e ministrit të Drejtësisë për heqjen e licencës për ushtrimin e profesionit të noterit, të cilët përmbajnë dhe detyrimin e dorëzimit të arkivit dhe vulave noteriale, si dhe për marrjen në dorëzim të arkivave të ish-noterëve.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë mund të kërkojë bashkëpunimin e Dhomën Kombëtare të Noterisë për të evidentuar nëse arkivat janë marrë në dorëzim nga noterët dhe noterin që ka marrë në dorëzim arkivën. Dhoma Kombëtare e Noterëve nëse ka dijeni, informon nëse arkivat mbahen në ngarkim nga persona të tretë.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë, në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Noterisë, identifikon noterët që kanë ndërruar jetë, trashëgimtarët e tyre ligjorë apo testamentarë, të cilët mund të kenë dijeni apo kanë në ngarkim arkivën e padorëzuar.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë kërkon bashkëpunimin e Zyrave të Gjendjes Civile për përcjelljen e çertifikatave familjare të ish-noterëve, me qëllim identifikimin e personave të cilët mund të kenë dijeni apo kanë në ngarkim arkivën e padorëzuar.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë pas evidentimit të listës së plotë të ish-noterëve që nuk kanë dorëzuar arkivën noteriale, brenda 45 ditëve pune, dërgon njoftimin, me postë të porositur, për dorëzimin prej tyre apo prej personave të tretë, në mënyrë vullnetare të arkivës përkatëse.

7. Për marjen e arkivit në dorëzim, personi (ish-noteri, personi i ngarkuar prej tij ose personi që ka në ruajtje arkivin), njoftohet të paktën 10 ditë përpara për ditën dhe orën e dorëzimit dhe i jepet edhe një kopje e urdhrit të ministrit.

8. Kur personit nuk i dihet vendbanimi, si dhe kur njoftimi nuk mund të kryhet në asnjë prej vendeve të përcaktuara në nenin 151, të Kodit të Procedurës Administrative, kryhet njoftimi publik sipas parashikimit të nenit 162, të Kodit të Procedurës Administrative.

9. Në rast moszbatimi vullnetar, urdhri i ministrit të Drejtësisë për dorëzimin e dokumentacionit që përmban arkivi i noterit, përbën titull ekzekutiv dhe ngarkohet zyra e përmbarimit me ekzekutimin e tij sipas parashikimeve në ligjin për noterinë.

10. Ministria e Drejtësisë merr masa për ndjekjen e procedurave ligjore për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit mbi titullin ekzekutiv. Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë i kërkon sektorit të përfaqësimit gjyqësor në Ministrinë e Drejtësisë paraqitjen e kërkesës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit. Sektori i përfaqësimit gjyqësor paraqet në gjykatë kërkesën brenda 20 ditëve nga përfundimi i afatit të përcaktuara në pikën 7 ose 8, të këtij urdhri. Pas lëshimit të urdhrit të ekzekutimit Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë i kërkon zyrës së përmbarimit shtetëror vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv. Ministria e Drejtësisë ndjek procedurat ligjore për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit mbi titujt ekzekutivë, urdhrat e ministrit të Drejtësisë për heqjen e licencës së ushtrimit të veprimtarisë noteriale dhe marrjen në dorëzim të arkivës noteriale.

11. Me administrimin e urdhrave përkatës të ekzekutimit, nxirret urdhri për ngritjen e komisioneve për marrjen në dorëzim të arkivave notarialë me përfaqësues nga Dhoma Kombëtare e Notarisë dhe degët vendore dhe dorëzimin e tyre noterëve të caktuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

12. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Notarisë.

13. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

URDHËR
Nr. 169, datë 10.6.2020

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR PARAQITJEN DHE TRAJTIMIN E SHPREHJEVE TË INTERESIT, SI DHE VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT TË KUSHTEVE LIGJORE PËR ANËTARË TË BORDIT DISIPLINOR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, të nenit 42, pika 4, të ligjit nr. 110/2018, "Për noterinë",

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullave për paraqitjen dhe për trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtarë të Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Notarisë.

2. Procesi i paraqitjes, trajtimit të shprehjes së interesit dhe verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore nga kandidatët, bëhet duke u bazuar në meritat e kandidatëve dhe duke respektuar parimet e përgjithshme të procedurës administrative.

3. Procedura e paraqitjes dhe shprehjes së interesit për anëtarë të Bordit Disiplinor, si dhe verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore dhe përzgjedhjes përfundimtare, sipas rregullave të këtij urdhri, bëhet për dy anëtarë që zgjidhen nga ministri i Drejtësisë, dy anëtarë që zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme e Dhomës Kombëtare të Notarisë dhe një anëtar që zgjidhet nga Këshilli Pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës, që zbatojnë kërkesat lidhur me fazat e shpalljes dhe të vlerësimit të kandidaturave, sipas këtij urdhri.

4. Kërkesa për shprehje interesi të kandidatëve publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, të Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe në atë të Shkollës së Magjistraturës për kandidatin respektiv, si dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe qëndron e hapur për një periudhë prej 15 ditësh nga data e shpalljes.

5. Kandidatët e interesuar duhet të depozitojnë me postë, dorazi në protokollin e institucionit apo në rrugë elektronike pranë institucionit përkatës dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesë për shprehje interesi;

b) jetëshkrim;

c) kopje të mjetit të identifikimit;

ç) diplomë që vërteton përfundimin e ciklit të dytë të studimeve universitare për drejtësi ose diplomë të njësuar me të;

d) vërtetim nga punëdhënësi aktual apo ai i mëparshëm, ku të përcaktohet vjetërsia në punë dhe fakti nëse ka apo jo masa disiplinore, shoqëruar me kopje të librezës së punës;

dh) autorizim për verifikimin e gjendjes gjyqësore;

e) deklaratë se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit në kuptimin e legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe autorizimin përkatës për kryerjen e verifikimeve;

ë) deklaratë se nuk ka asnjë anëtar të familjes, si dhe të afërm të shkallës së parë që është noter në detyrë;

f) çdo dokument tjetër provues që vërteton plotësimin e kritereve ligjore.

6. Afati për dorëzimin e dokumentacionit pranë institucionit përkatës është 10 ditë nga përfundimi i afatit të përcaktuar në pikën 4 të këtij urdhri.

7. Në rast të mbarimit para kohe të mandatit të njërit prej anëtarëve, ndiqet e njëjta procedurë, jo më vonë se 10 ditë pas marrjes dijeni për mbarimin e mandatit.

8. Procedura administrative e verifikimit të kandidatëve fillon jo më vonë se 5 ditë nga mbarimi i afatit për dorëzimin e dokumentacionit dhe përfundon jo më vonë se 20 ditë nga data e nisjes.

9. Për secilin kandidat që ka përcjellë shprehje interesi përgatitet relacion, me të cilin kandidati ka të drejtë të njihet në përfundim të procedurës administrative.

10. Ngritja e grupeve të brendshme të punës dhe organizimi i punës për kryerjen e procesit të vlerësimit të shprehjeve të interesit, deri në vendimmarrje, përcaktohen në përputhje me aktet e brendshme të titullarëve ose të organeve drejtuese të institucioneve përkatëse.

11. Pas procesit të vlerësimit, secilit kandidat i njoftohet vendimmarrja, së bashku me relacionin e përgatitur për kandidatin.

12. Kandidatët e interesuar, kanë të drejtën e ankimit brenda 3 ditëve nga dita e njoftimit, sipas pikës 11 të këtij urdhri.

13. Lista përfundimtare e renditjes së kandidatëve publikohet përkatësisht në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, të Shkollës së Magjistraturës apo të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

14. Vendimi për kandidatin fitues, formalizohet me aktin përkatës administrativ të ministrit të Drejtësisë, Asamblesë së Përgjithshme të Dhomës apo Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës dhe publikohet në faqen zyrtare të institucionit përkatës dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe i komunikohet njëkohësisht kandidatëve fitues dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë.

15. Nëse kandidati fitues, sipas renditjes përfundimtare, tërhiqet, përzgjidhet kandidati i renditur menjëherë pas tij në listë.

16. Në aktin administrativ përcaktohet data e fillimit të mandatit dhe data e mbarimit te tij, sipas ligjit për noterinë.

17. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe Shkolla e Magjistraturës e Republikës së Shqipërisë.

18. Ngarkohet Sektori i Arkiv Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

URDHËR
Nr. 170, datë 10.6.2020

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR SKEMËN E KOMPENSIMIT DHE FUNKSIONIMIN E BORDIT DISIPLINOR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, dhe të nenit 42, pika 13, të ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë",

URDHËROJ:

1. Miratimin e "Rregullores për skemën e kompensimit dhe funksionimin e Bordit Disiplinor", sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe Bordi Disiplinor për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
3. Ngarkohet Sektori i Arkiv Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

RREGULLORE
PËR SKEMËN E KOMPENSIMIT DHE FUNKSIONIMIN E BORDIT DISIPLINOR

TITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore përcakton rregulla të hollësishme për skemën e kompensimit dhe funksionimin e Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë, bazuar në kërkesat e ligjit për noterinë dhe parimet e përgjithshme të Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 2
Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje, me termat e mëposhtëm, do të kuptohet:

a) "Bordi Disiplinor" do të thotë organ hetimor *ad hoc*, i cili mbështetet administratisht nga Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe shqyrton kërkesat e Ministrit të Drejtësisë për procedim disiplinor ndaj noterëve ose zëvendësnoterëve;

b) "Hetime" janë tërësia e veprimeve procedurale administrative që ndërmerren nga Bordi Disiplinor për të sqaruar një çështje të veçantë;

c) "Provë" është çdo e dhënë, dëshmi, dokument apo fakt që shërben në nxjerrjen e konkluzioneve të procedimit disiplinor dhe që merret sipas dispozitave ligjore dhe të kësaj rregulloreje;

ç) "Dëshmitar" është personi i thirrur nga Bordi Disiplinor për të dëshmuar mbi ngjarjet dhe faktet, vetëm dhe për shkak të lidhjes me çështjen objekt shqyrtimi;

d) "Ekspertë" janë persona që për shkak të njohurive të posaçme në fushat e shkencës, teknikës apo në fusha të tjera specifike thirren nga Bordi Disiplinor, kur kjo e fundit e konsideron të përshtatshme;

dh) "Vendim jopërfundimtar" është vendimi i Bordit Disiplinor, i marrë në çdo fazë të procedimit disiplinor për zhvillimin normal të veprimtarisë dhe procedurave të mëtejshme të hetimit, të pyetjes së dëshmitarëve, shtyrjes së seancës, angazhimin e ekspertëve dhe përcaktimin e detyrave të tyre, pranueshmërinë e provave, si dhe për çdo çështje tjetër që Bordi Disiplinor e vlerëson të nevojshme ose të përshtatshme në trajtimin e çështjes;

e) "Vendim përfundimtar" është vendimi që merret nga Bordi Disiplinor, për pranimin e kërkesës për procedim disiplinor dhe marrjen e një ose më shumë masave disiplinore ose rrëzimin e kërkesës.

Neni 3
Fusha e veprimtarisë së Bordit

Bordi Disiplinor është krijuar me ligj për të hetuar, shqyrtuar dhe vendosur mbi të gjitha rastet që lidhen me procedimet disiplinore ndaj noterëve ose zëvendësnoterëve, pas paraqitjes së raportit të

hetimit së bashku me dosjen hetimore përkatëse nga ministri i Drejtësisë.

TITULLI II
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I BORDIT DISIPLINOR

Neni 4
Mënyra e organizimit të Bordit Disiplinor dhe kompensimi

1. Mbledhja e Bordit Disiplinor është e vlefshme kur në të janë të pranishëm jo më pak se 3 anëtarë.

2. Kryetari i Bordit Disiplinor zgjidhet me shumicë absolute në mbledhjen e parë të Bordit, në prani të të gjithë anëtarëve të Bordit Disiplinor.

3. Bordi Disiplinor mblidhet jo më vonë se 15 ditë nga mbarimi i mandatit të kryetarit për të zgjedhur kryetarin e ri.

4. Veprimtaria administrative e Bordit Disiplinor mbështetet nga stafi administrativ i Dhomës Kombëtare të Noterisë.

5. Masa e kompensimit është 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për kryetarin e Bordit Disiplinor dhe 10 000 (dhjetë mijë) lekë për secilin anëtar të Bordit Disiplinor për çdo procedim disiplinor.

6. Dhoma kryen kompensimin e kryetarit, si dhe anëtarëve të Bordit Disiplinor nga buxheti i saj jo më vonë se data 5 e çdo muaji pasardhës, në rastet kur gjatë muajit ka pasur procedime disiplinore.

7. Shpenzimet për mbulimin e kostove administrative të punës së Bordit Disiplinor përballohen nga Dhoma Kombëtare e Noterisë.

Neni 5
Kompetencat funksionale të Bordit Disiplinor

1. Bordi Disiplinor shqyrton të gjitha raportet e hetimit së bashku me dosjet hetimore për procedimin disiplinor ndaj noterëve ose zëvendësnoterëve të paraqitura nga ministri i Drejtësisë.

2. Bordi Disiplinor kryen të gjitha veprimet e nevojshme hetimore me qëllim realizimin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm administrativ në përputhje me normat e Kodit të Procedurave Administrative, kur ligji për noterinë nuk parashikon ndryshe.

Neni 6
Detyrat e kryetarit dhe anëtarit të Bordit Disiplinor

1. Kryetari i Bordit Disiplinor kryen këto detyra:

a) administron raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore të paraqitur nga ministri i Drejtësisë për procedimin disiplinor ndaj noterit ose zëvendësnoterit;

b) informon palët për zhvillimin e seancës së paku 10 ditë përpara;

c) cakton dhe njofton kohën dhe vendin e seancës dhe merr konfirmimin me shkresë ose mjete elektronike të anëtarëve të Bordit Disiplinor, palëve, si dhe personave të tjerë të interesuar të cilët do të jenë pjesëmarrës në seancë. Kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm të paktën 3 anëtarë, kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër të afërt. Në rast se subjekti i procedimit disiplinor ose përfaqësuesi ligjor i tij nuk është i pranishëm, vlerëson shkaqet e mosparaqitjes në seancë. Në rast se mosparaqitja ka ndodhur për shkaqe që nuk vlerësohen të arsyeshme, vendos vijimin e seancës pa praninë e subjektit ose përfaqësuesit të tij ligjor. Në rastet kur vlerësohet se subjekti i procedimit ka paraqitur shkaqe të arsyeshme apo shkaqe të cilat vlerësohen si të tilla, Bordi shtyn mbledhjen duke kryer një njoftim të dytë për një datë tjetër sa më të afërt. Nëse edhe në këtë datë subjekti i njoftuar rregullisht dhe/ose përfaqësuesi i tij nuk paraqiten para Bordit, vendoset vazhdimi i seancës në mungesë.

ç) cakton dhe njofton rendin e ditës së mbledhjes, si dhe cakton relatorin e çështjes, referuar dosjes hetimore përkatëse për procedim disiplinor të paraqitur nga ministri i Drejtësisë;

d) informon anëtarët e Bordit në lidhje me detyrimin për t'u shprehur brenda 2 (dy) ditësh nga momenti i marrjes së njoftimit, nëse kanë konflikt interesi apo dyshime mbi paanësinë e tyre në vendimmarrjen e Bordit Disiplinor, si dhe noterin/zëvendësnoterin, subjekt të procedimit disiplinor nëse ka konflikt interesi me një prej anëtarëve të Bordit Disiplinor;

dh) merr vendim për tërheqjen e anëtarit të Bordit Disiplinor, kur ka konflikt interesi apo ka

dyshime në lidhje me paanësinë e tyre në vendimmarrje, jo më vonë se 5 (pesë) ditë përpara datës së seancës;

e) hap, mbyll dhe drejton seancën duke siguruar mbarëvajtjen në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje;

ë) pyet nëse ka kërkesa paraprake nga palët. Kërkesat paraprake vlerësohen nga Bordi Disiplinor me vendim jo përfundimtar.

f) shtyn apo mbyll para kohe mbledhjet, në mënyrë të përligjur, duke e arsyetuar me vendim të pasqyruar në procesverbalin përkatës;

g) nënshkruan të gjithë aktet e nxjerra nga Bordi Disiplinor;

gj) administron materialet e nevojshme, të cilat mund të kërkohen nga anëtarët e tjerë;

h) kryen ballafaqimet dhe saktësimet e kërkuara nga anëtarët e tjerë, si dhe njofton mbylljen e diskutimeve;

i) thërret dëshmitarë nëse ka, për dëshmi shtesë apo ekspertët nëse janë të angazhuar nga Bordi;

j) u jep fjalën anëtarëve të tjerë të Bordit ose personave të tjerë të interesuar, nëse ata e kërkojnë, për të paraqitur pretendimet dhe sqarimet e tyre;

k) siguron zbatimin e ligjit procedural dhe material të zbatueshëm për organet kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike dhe marrjen e vendimeve të drejta.

2. Në rastet kur kryetari, nuk thërret mbledhjen brenda afatit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 7 ose nuk merr pjesë në të, pavarësisht shkakut, detyrat e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, ushtrohen nga anëtari i zgjedhur nga ministri i Drejtësisë që ka më shumë vite përvojë profesionale si jurist.

3. Anëtari i Bordit Disiplinor kryen të paktën këto detyra:

a) përcjell me shkrim ose në rrugë elektronike konfirmimin për pjesëmarrje në mbledhjen e Bordit pranë kryetarit të Bordit Disiplinor;

b) bën relatimin e çështjes në seancë para Bordit Disiplinor, në rastin kur ai është anëtari i zgjedhur nga kryetari sipas germës "ç", të pikës 1, të këtij neni;

c) ruan të dhënat me të cilat është njohur gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij, duke respektuar parimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale sipas legjislacionit në fuqi;

ç) tërhiqet nga shqyrtimi i çështjes, nëse ndodhet para kushteve të përcaktuara në shkronjën "d", të pikës 1 të këtij neni;

d) voton për vendimet që merr Bordi Disiplinor, me përjashtim të rastit kur tërhiqet nga shqyrtimi i çështjes, sipas germës "ç", të pikës 2, të këtij neni.

Neni 7

Mbledhja e Bordit Disiplinor

1. Bordi Disiplinor mblidhet dhe zhvillon seancën dëgjimore jo më vonë se 15 ditë nga paraqitja e raportit të hetimit së bashku me dosjen hetimore nga ministri i Drejtësisë për procedim disiplinor.

2. Kryetari cakton datën e mbledhjes jo më vone se 3 ditë nga marrja e raportit të hetimit. Çdo ndryshim për datën e mbledhjes i njoftohet pa vonesë çdo anëtari të Bordit. Afati për zhvillimin e seancës dëgjimore mund të zgjatet deri në 45 ditë, nëse Bordi Disiplinor është i bindur se ka arsye të rëndësishme për shtyrjen.

3. Dokumentimi i veprimtarisë së Bordit Disiplinor pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes, i cili mbahet nga sekretari që zgjidhet nga radhët e anëtarëve, nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e kryetarit dhe përmban:

a) datën dhe vendin e mbledhjes;

b) anëtarët që marrin pjesë në mbledhje;

c) çështjet që u diskutuan në mbledhje;

ç) vendimet që u morën në mbledhje, argumentet për vendimmarrje, afatet e përcaktuara në vendimmarrje;

d) dorëheqjet e anëtarëve dhe arsyetimet përkatëse;

dh) formën e votimit (i hapur ose jo) dhe rezultatin e tij;

e) rezultatet e votimit, mënyrën e votimit të secilit anëtar dhe arsyetimin e votimit nga secili anëtar;

4. Procesverbali i mbledhjes u paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse. Pas miratimit, procesverbali nënshkruhet së bashku nga kryetari, sekretari dhe një nga anëtarët e zgjedhur nga ministri i Drejtësisë.

5. Mbledhjet e Bordit Disiplinor dokumentohen edhe nëpërmjet regjistrimit audio.

6. Një kopje e procesverbalit të mbledhjes, regjistrimi audio, transkriptimi i tij, nëse është e mundur dhe të çdo materiali tjetër të administruar gjatë zhvillimit të saj depozitohet së bashku me vendimin përfundimtar të arsyetuar pranë ministrit të Drejtësisë.

Neni 8
Detyrimi për të marrë pjesë në mbledhje

1. Pjesëmarrja në mbledhjet e Bordit Disiplinor është e detyrueshme. Në rastet kur një anëtar nuk merr pjesë në tre mbledhje të njëpasnjëshme, pa një shkak të ligjshëm, konsiderohet që ka hequr dorë si anëtar i Bordit Disiplinor. Në këtë rast kryetari njofton menjëherë organin e emërtesës dhe ministrin e Drejtësisë. Në rastin kur kryetari nuk merr pjesë në tre mbledhje të njëpasnjëshme, detyrimin për të njoftuar sipas këtij neni e ka anëtari i zgjedhur nga ministri i Drejtësisë që ka më shumë vite përvojë profesionale si jurist.

2. Organi i emërtesës fillon procedurën për zgjedhjen e anëtarit të ri të Bordit Disiplinor jo më vonë se 15 ditë nga data e marrjes së njoftimit.

Neni 9
Marrja e vendimeve nga Bordi Disiplinor

1. Bordi Disiplinor merr vendime vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes. Bordi Disiplinor vendos për bashkimin e procedimeve, shtimin apo ndryshimin e objektit të procedimit disiplinor, sipas përcaktimeve të ligjit për noterinë.

2. Bordi Disiplinor merr vendim në lidhje me angazhimin e ekspertëve dhe përcaktimin e detyrave të tyre, shtyrjen e seancave, pranueshmërinë e provave, zgjidhjen e çështjes, si dhe çdo çështje tjetër që e vlerëson të nevojshme ose të përshtatshme në trajtimin e çështjes.

3. Marrja e vendimeve në mbledhjen e Bordit bëhet me votim, i cili është individual dhe i hapur.

4. Përjashtimisht, votimet që kanë të bëjnë me etikën, cilësitë ose sjelljet e subjektit të procedimit disiplinor merren me votim të fshehtë.

5. Secili prej anëtarëve ka të drejtën e ushtrimit të një vote. Në asnjë rast, e drejta e votës nuk mund t'i delegohet ndonjë anëtari tjetër të Bordit.

6. Vendimet e Bordit Disiplinor për çështje disiplinore miratohen me shumicën e të gjithë anëtarëve të Bordit. Anëtari në pakicë mund të kërkojë që të shënohet në procesverbal fakti dhe arsyet e votimit kundër një vendimi të marrë nga Bordi.

7. Votat e anëtarëve të Bordit Disiplinor regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes.

TITULLI III
PROCEDURA PËRPARA BORDIT DISIPLINOR

Neni 10
Njoftimi i subjektit ndaj të cilit ka filluar procedimi disiplinor

1. Subjekti ndaj të cilit ka filluar procedimi disiplinor njoftohet në lidhje me:

a) faktin se ndaj tij ka filluar procedim disiplinor dhe zhvillimin e seancës dëgjimore së paku 10 ditë përpara;

b) për të marrë pjesë në seancë dëgjimore;

c) të drejtën për të paraqitur me shkrim parashtresat mbrojtëse në afatin e caktuar;

ç) të drejtën për paraqitjen e dokumenteve brenda afatit të caktuar nga Bordi Disiplinor dhe thirrjen e dëshmitarëve që mund të dëshmojnë fakte me interes për çështjen;

d) të drejtën për t'u përfaqësuar, sipas parashikimeve në Kodin e Procedurave Administrative;

dh) të drejtën për të marrë masa të tjera për paraqitjen e provave në mbështetje të mbrojtjes së tij;

2. Njoftimi i subjektit për të cilin është vendosur fillimi i procedimit disiplinor bëhet nëpërmjet postës elektronike zyrtare dhe në rrugë postare në adresat e deklaruara në regjistrat përkatës.

3. Palët kanë të drejtë të njoftohen për çdo vendim të Bordit Disiplinor, brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

Neni 11
Vendimi përfundimtar

1. Pas shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe provave, Bordi Disiplinor vendos:

a) për rrëzimin e kërkesës për procedim disiplinor, për shkak se faktet e pretenduara nuk kanë ndodhur ose ato nuk përbëjnë shkelje disiplinore; ose

b) pranimin e kërkesës, marrjen e një ose më shumë masave disiplinore dhe njoftimin e vendimit të ministrit të Drejtësisë, me qëllim nxjerrjen e urdhrit përkatës.

2. Bordi Disiplinor shqyrton masën disiplinore të propozuar nga ministri i Drejtësisë dhe jep vendim të arsyetuar me shkrim brenda dy javëve nga përfundimi i seancës.

3. Vendimi përfundimtar përmban:

a) organin që ka marrë vendimin;

b) identitetin e subjektit ndaj të cilit është zhvilluar procedimi disiplinor;

c) datën e miratimit;

d) rrethanat e faktit dhe shkelja/shkeljet e pretenduara;

e) bazën ligjore;

f) pjesën arsyetuese;

g) dispozitivin që tregon;

h) të drejtën dhe afatet e ankimit;

i) nënshkrimin e kryetarit dhe sekretarit të Bordit Disiplinor.

Neni 12
Nxjerrja e urdhrit të ministrit të Drejtësisë

1. Ministri i Drejtësisë, brenda 2 javëve nga data e paraqitjes së vendimit të Bordit Disiplinor dhe materialeve shoqëruese, nxjerr urdhrin për zbatimin e masave që vendosen në procedimin disiplinor, në të cilin parashikohen edhe modalitetet e zbatimit të tij.

2. Urdhri për zbatimin e masës disiplinore jepet i arsyetuar dhe i njoftohet noterit/zëvendësnoterit dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, me shkrim brenda 5 ditëve nga nxjerrja e tij.

3. Vendimi i formës së prerë për masën disiplinore evidentohet në regjistrin e noterëve a zëvendësnoterëve.

Neni 13
Ankimi

Kundër çdo vendimi të Bordit Disiplinor për shkelje disiplinore, ministri i Drejtësisë, noteri ose zëvendësnoteri mund të bëjë ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

URDHËR
Nr. 165, datë 9.6.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 14, DATË 16.1.2020 "PËR SHPALLJEN E 'THIRRJES SË PESTË', NË KUADËR TË PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 6, të vendimit nr. 395, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në administratën shtetërore dhe në institucionet e tjera publike", të ndryshuar, dhe të pikës 7, të urdhrit nr. 351, datë 29.5.2020, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, "Për marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së COVID-19",

URDHËROJ:

1. Në metodologjinë dhe Planin e Veprimit në kuadër të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, " Thirrja e Pestë", bashkëlidhur urdhrit nr. 14, datë 16.1.2020, bëhen këto ndryshime:

a) në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3, data "*9 mars 2020*" zëvendësohet me datën "*12 qershor 2020*".

b) shkronja "b" e pikës 4, ndryshon si më poshtë:

"b) Programi fillon më datë ***12 qershor 2020*** dhe përfundon më datë ***12 shtator 2020".***

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

VENDIM
Nr. 91, datë 2.6.2020

MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE, TË NISUR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 87, DATË 19.5.2020, "PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 402, SERIA P18, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 83, DATË 6.4.2018, 'PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË 'FAVINA 1' SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC 'VOSKOPOJË', ME KAPACITET TË INSTALUAR 1970 kw"'

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 64, 90, pika 3, 94, pika 1 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; nenit 15 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 15 të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 87, datë 19.5.2020,

konstatoi se:

- Shoqëria "Favina 1" sh.p.k., me shkresën nr. 17 prot., datë 16.4.2020, protokolluar në ERE me nr. 650, datë 22.4.2020, ka përcjellë kërkesën për modifikimin e licencës nr. 402, seria P18, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 6.4.2018, "Për licencimin e shoqërisë 'Favina 1' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC 'Voskopojë', me kapacitet të instaluar 1970 *kw*".

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 87, datë 19.5.2020, vendosi për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës nr. 402, seria P18, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 6.4.2018, "Për licencimin e shoqërisë 'Favina 1' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC 'Voskopojë', me kapacitet të instaluar 1970 *kw*".

- Në datë 19.5.2020, në ERE, është depozituar shkresa e shoqërisë "Favina 1" sh.p.k. "Njoftim për anulimin e kërkesës për modifikimin e licencës nr. 402, seria P18, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 6.4.2018, "Për licencimin e shoqërisë 'Favina 1' sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC 'Voskopojë', me kapacitet të instaluar 1970 *kw*", nëpërmjet së cilës kërkon që ERE të mos marrë në konsideratë kërkesën për modifikimin e licencës së sipërcituar, pasi për shkak të kushteve të vështira të krijuara nga pandemia COVID-19, ndodhet në pamundësi financiare për të investuar shtesën e kapacitetit të instaluar të HEC-it "Voskopojë" nga 1970 *kw* në 2400 *kw*.

- Neni 64 i Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 2, parashikon se:

- Një palë, me anë të një kërkese me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dore nga të drejtat dhe interesat e saj ligjore, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj.

- Pas tërheqjes së një pale, organi publik vendos përfundimin e procedurës administrative.

- Në pikën 1 të nenit 94 të Kodit të Procedurave Administrative, parashikohet se: si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 87, datë 19.5.2020, "Për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës nr. 402, seria P18, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 6.4.2018, 'Për licencimin e shoqërisë 'Favina 1' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC 'Voskopojë', me kapacitet të instaluar 1970 kw"'.

2. Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 87, datë 19.5.2020, "Për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës nr. 402, seria P18, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 6.4.2018, "Për licencimin e shoqërisë 'Favina

1' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC 'Voskopojë', me kapacitet të instaluar 1970 *kw*", shfuqizohet.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 92, datë 2.6.2020

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "POWERCOMM" SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "e", 5, pika 1, germa "e" dhe nenit 13, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15, të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.6.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi licencimin e shoqërisë "PowerComm" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 82, datë 4.5.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë "PowerComm" shpk, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike;

- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median elektronike me *email*-in e datës 4.5.2020 dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria "PowerComm" sh.p.k.;

- Me shkresën nr. 662/2, datë 13.5.2020, i është dërguar shoqërisë shkresa për njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës dhe kërkesa për plotësimin e dokumentacionit të munguar;

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria "PowerComm" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 662/3, datë 20.5.2020, ka paraqitur dokumentacionin e munguar;

- Shoqëria "PowerComm" sh.p.k., është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), në datën 1.3.2018, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" (QKB) me statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

- Aplikimi i Shoqërisë "PowerComm" sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b" "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d", "e") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c", "d") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat "a", "b", "c", "d") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "PowerComm" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 560 lekë